




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



MODULI 2

Shkolla e mirë Mësimdhënia dhe të nxënit cilësor

Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqje Arsimore



Fakulteti i Edukimit



MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

MODULI 2

Shkolla e mirë Mësimdhënia dhe të nxëniet cilësor

Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore

Falënderim

Ky material është zhvilluar dhe publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane.

Teksti origjinal në gjuhën Shqipe [2017] dhe i rishikuar [2020]

E drejta për përdorim, riprodhim dhe redaktim i është bartur Universitetit të Prishtinës – Fakultetit të Edukimit dhe Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit [2021]

Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo të Qeverisë Gjermane.

Autorë:

Carmen Matheis, Landesakademie Badiltdbad, Gjermani
M.Sc Selim Mehmeti

Rishikuar nga:

Marianne Müller RSD Freiburg, Germany

Mr.sc Arlinda Gashi Bajgora

Dr. Naser Zabeli, Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Dr. Osman Buleshkaj, ekspert i arsimit

Koordinuar nga:

Lirie Lokaj, GIZ

Dizajni dhe faqosja nga:

Envinion, Prishtinë



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbajtja

Akronimet dhe Shkurtesat	5
1. Hyrje	7
1.1. Qëllimi i modulit.....	7
1.2. Rezultatet e pritura.....	8
2. Ç'kuptojmë me shkollën e mirë?.....	11
2.2. Çfarë e bën shkollën një shkollë të mirë bazuar në dokumentet e MASH?.....	15
3. Të nxëniet dhe mësimdhënia.....	16
3.1. Të nxëniet?.....	16
3.2. Mësimdhënia cilësore.....	20
3.3. Njëzetë karakteristika të vëzhgueshme të mësimdhënies efektive – mësimdhënësi efektiv.....	21
3.4. Cilat janë synimet e arsimit?.....	22
3.5. Korniza e kurrikulës së Kosovës: Përgatitja për ndryshim.....	23
3.5.1. Kurrikula e Kosovës–elementet themelore.....	24
3.6. Fazat kyçe të kurrikulës	25
3.7. Roli i veçantë i mësimdhënësve	27
3.8. Çka nënkupton e gjithë kjo për drejtorë të shkollave?.....	30
3.9. Të nxëniet dhe mësimdhënia elektronike.....	34
3.10. Modeli online /Mësimi nga distanca	36
3.10. Modeli online –Mësimi nga distanca	36
4. Performanca e nxënësve	39
4.1. Vlerësimi i mësimnxënies dhe për mësimnxënien.....	39
4.1.1. Përkufizimi i vlerësimit, parimet e vlerësimit dhe objektivat.....	40
4.2. Parimet dhe objektivat për procesin e vlerësimit.....	41
4.2.1. Parimet e vlerësimit.....	41
4.2.2. Objektivat e vlerësimit.....	41
4.3. Llojet e vlerësimit të kërkuara sipas kkk-së.....	42
4.3.1. Vlerësimi me bazë në shkollë.....	42
4.3.2. Vlerësimi i jashtëm	44
5. Kultura dhe mjedisi i shkollës	47
5.1. Aktivitetet jashtëkurrikulare.....	47
5.2. Pjesëmarrja e komunitetit	49
5.3. Rregullat e sjelljes në shkollë.....	51
5.3.1. Procesi i hartimit të rregullave të shkollës.....	53

Përmbajtja

5.3.2. Trajtimi i konflikteve	55
5.3.3 Monitorimi i zbatimit të rregullave të shkollës.....	56
5.4. Gjithëpërfshirja	47
6 Fokusi mbi strategjinë e zhvillimit të cilësisë.....	58
6.1. Sigurimi i cilësisë në nivel të shkollës	59
6.1.1. Personeli i shkollës përgjegjës për koordinim të cilësisë në shkolla	59
6.2. Roli i drejtorit të shkollës në krijimin e kulturës bashkëpunuese me të gjithë e për të gjithë.....	60
6.3. Roli i pedagogut dhe psikologut në shkollë	61
6.4. Vizioni i shkollës.....	63
Fjalorthi.....	65
Referencat	67
Shtojcat.....	70
Shtojca 1: Vlerësimi për të nxënë	70
Shtojca 2: Korniza për sigurim të cilësisë së vlerësimit të performancës së shkollës....	74
Shtojca 3: Treguesit e performancës së shkollës.....	85
Shtojca 4: Instrumentet për vlerësimin e performancës së shkollës.....	94

Akronimet dhe Shkurtesat

UA	Udhëzimi Administrativ
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
EpGj	Edukimi për të Gjithë
BE	Bashkimi Evropian
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
GIZ CDBE	GIZ Ngritja e Kapaciteteve në Arsimin Fillor
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
SZhM	Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
SSC	Strategjia për Sigurimin e Cilësisë
SZhQ	Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
KDSh	Këshilli Drejtues i Shkollës
DUDNj	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

MODULI I DYTË ADRESON DISA ASPEKTE TË STANDARDEVE TË PRAKTIKËS PROFESIONALE TË DREJTORËVE TË SHKOLLAVE

Në mënyrë të drejtëpërdrejtë ky Modul adreson Standardin 2 "Mësimdhënia dhe të nxënit cilësor" përmes temave në vijim:

→ Shkolla e mirë

→ Të nxënit dhe mësimdhënia

→ Korniza Kurrikulare dhe dokumentet përcjellëse kurrikulare

→ Performanca dhe vlerësimi i nxënësve

→ Kultura e shkollës dhe gjithëpërfshirja

→ Sigurimi i cilësisë në shkollë

→ Vlerësimi i performancës së shkollës

1. Hyrje

Programi Ngritja e Kapaciteteve në Sektorin e Arsimit Fillor në Kosovë (CDBE) ndër aktivitetet e tjera synon të kontribuojë në menaxhimin dhe udhëheqjen efikase dhe të orientuar drejtë cilësisë së shkollave fillore dhe të mesme të ulëta.

Në këtë kontekst, përmirësimi i menaxhimit dhe qeverisjes së shkollave kuptohet si një detyrë që përfshin si drejtorët e shkollave (dhe ekipet e tyre të menaxhimit/Këshillin Drejtues të Shkollave, bashkëpunëtorët profesional të shkollës: pedagogun, psikologun apo edhe koordinatorët e cilësisë, aktivat profesionale) dhe stafin e DKA-ve. Programi synon forcimin e shkollave dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre për t'u përballur me sfida të reja.

Me procesin e decentralizimit dhe autonomisë së shkollës, roli dhe funksioni i drejtorit të shkollës ndryshon në mënyrë të konsiderueshme jo vetëm për menaxhimin e përditshëm të shkollës, por edhe për sigurimin e zhvillimit të ardhshëm dhe rritjen e cilësisë së arsimit në shkollë.

Me rishikimin e programit ekzistues të trajnimit të Menaxhimit të Arsimit synohet ngritja e mëtejshme e kapaciteteve menaxhuese të drejtorëve të shkollave, stafit të DKA-ve dhe rritjen e konkurrencës së kandidatëve të trajnuar për pozitën e drejtorëve të shkollave dhe menaxherëve të institucioneve të tjera arsimore.

Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) në kuadër të Fakulteti i Edukimit, me mbështetjen e GIZ-CDBE kanë rishikuar programin bazuar në programet e trajnimit menaxhues të orientuar drejt kërkesës (trajtime në shërbim si për drejtorët e shkollave ashtu edhe për Drejtoritë Komunale të Arsimit).

Qëllimi i përgjithshëm i programit të trajnimit është të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit të shkollës në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit për të gjithë. Për këtë qëllim, aspektet relevante janë identifikuar dhe shtjelluar në bazë të vlerësimit të trajnimeve. Programi përbëhet nga 7 module, secili prej tyre shërben për një qëllim të caktuar dhe përcakton rezultatet e pritura.

1.1 Qëllimi i Modulit

Një nga detyrat kryesore të drejtorit të shkollës është që të drejtojë dhe menaxhojë shkollën me fokus në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit. Si udhëheqës dhe menaxher i stafit, drejtori i shkollës duhet të analizojë situatën e tanishme në shkollë, ta përmirësojë së bashku me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit, të krijojë qëllime afatgjata dhe një plan për t'i arritur ato synime si dhe për të udhëzuar zbatimin e këtij plani. Hapi i parë në këtë rrugë është diskutimi dhe vlerësimi i efektivitetit të shkollës. Institucionet arsimore bëjnë analiza dhe hulumtime me qëllim që të kuptojnë nivelin e tyre të arritjeve krahasuar me qëllimet e vëna, pavarësisht nëse është fjala për nivelin ndërkombëtar, kombëtar apo komunal apo ambicie të vetë shkollës, të deklaruara në vizionin e shkollës. Moduli i mëparshëm mbi cilësinë e arsimit paraqet disa indikatorë të rëndësishëm për cilësi. Krahasimi gjithashtu mund të bëhet ndërmjet shkollave: gara për të qenë një nga shkollat më të mira mund të jetë një motor (nxitës) i fuqishëm për ndryshim.

Shpesh drejtorët e shkollave dhe Këshilli Drejtues i Shkollës nuk e dinë vërtetë nga të fillojnë. Nganjëherë shtë vështirë për t'iu përgjigjur pyetjeve sikur: Sa është e mirë shkolla jonë? Cilat janë përparësitë tona? Çfarë lloji të shkollës ne duam për një afat të gjatë? Ne kemi nevojë për analizë dhe vlerësim të situatës së tanishme për të identifikuar përmirësimin e nevojshëm të shkollës. Për këtë njohuri nevojitet përvoja, të dhëna të sakta, instrumente të standardizuara dhe udhëheqje se si të shfrytëzohen ato.

Doracaku *Shkolla e mirë - Mësimdhënia dhe të nxënit cilësor* sjell shpjegime për konceptin shkolla e mirë që përbëhet nga përvoja e praktika të mira të mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore dhe vlerësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të punës në shkollë.

Moduli *Shkolla e Mirë – Mësimdhënia dhe të nxënit cilësor* ka për qëllim që vijuesve të trajnimit t' u ofrojë njohuri bazë mbi parimet e një shkolle të mirë të lidhura me standardet e cilësisë, mbi hapat e vlerësimit të cilësisë së tanishme të arsimit dhe zhvillimin e vizionit afatgjatë së bashku me mësimdhënësit, prindërit, Këshillin Drejtues të Shkollës me qëllim të përmirësimit të performancës së shkollës dhe rezultateve mësimore të nxënësve.

Objektiv i modulit është të ngritët kënaqësia e nxënësve, mësimdhënësve, personelit të shkollës dhe prindërve me cilësinë e arsimit dhe shërbimet tjera të shkollës dhe gjithashtu të përkrahë shkollat gjatë përgatitjes së Planit Zhvillimor të Shkollës (PZhSh), i cili plan do të duhej të plotësojë kriteret e cilësisë.

1.2 Rezultatet e pritura

Duke marrë parasysh temat që do të trajtohen në këtë Modul, pritët që pjesëmarrësit e trajnimit mbi udhëheqje arsimore, edukatorët dhe menaxherët e shkollave në Kosovë të arrijnë rezultatet vijuese themelore:

- ✓ *Përshkruajnë karakteristikat kryesore të një shkolle të mirë*
- ✓ *Identifikojnë indikatorët për secilën prej fushave të cilësisë*
- ✓ *Identifikojnë indikatorët për secilën prej fushave të cilësisë*
- ✓ *Shpjegojnë elementet themelore të mësimin elektronik (mesimin online)*
- ✓ *Propozojnë indikatorë të ri për fushat e cilësisë*
- ✓ *Vlerësojnë rolet e drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve mbi ndikimin e tyre në mësimdhënien dhe mësimnxënien cilësore*
- ✓ *Gjykojnë mjetet e vlerësimit për efektivitetin e punës në shkollë*
- ✓ *Përgatisin një skicë/plan të vlerësimit të bazuar në shkollë për një vit shkollor*
- ✓ *Aplikojnë instrumentet e dhëna në udhëzimet për vlerësim në të gjitha fazat e hulumtimit dhe vlerësimit të performancës së shkollës*

- ✓ Hartojnë një plan për përfshirjen e komunitetit
- ✓ Hartojnë një plan për përfshirje dhe bashkëpunim me pedagogun dhe psikologun e shkollës
- ✓ Praktikojnë vlerësimin e performance së shkollës
- ✓ Hartojnë synimet/vizionin afatgjatë për shkollën së bashku me Këshillin Drejtues të Shkollës

Bazuar në rezultatet e pritshme, pjesëmarrësi në trajnim të udhëheqjes arsimore, më konkretisht pritet të arrijë rezultate si në vijim:


- ✓ Mbështet zhvillimin e gjithanshëm të potencialeve të çdo nxënësi, p.sh. zhvillimin njohës, emocional, social dhe fizik,
- ✓ Mundëson zhvillim maksimal të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve për shekullin 21,
- ✓ Bazon filozofinë e vet në gjithëpërfshirje,
- ✓ Ndjek përparimin individual të çdo nxënësi,
- ✓ Përgatit nxënësit për mësimnxënie gjatë gjithë jetës,
- ✓ Ka nxënësin si individ në qendër të gjithë veprimit
- ✓ Arrin rezultate dhe sukses të lartë dhe i dokumenton ato me të dhëna valide dhe të besueshme,
- ✓ Provon të arrijë mësimdhënie dhe mësimnxënie të mirë duke u bazuar në perceptimet aktuale shkencore,
- ✓ Tregon një kulturë stimuluese dhe inkurajuese të mësimnxënies përmes cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies,
- ✓ Ka një Këshill Funkcional për Menaxhim të Shkollës;
- ✓ Krijon klimë pozitive në shkollë,
- ✓ Bashkëpunon me faktorët kryesor në shkollë dhe partnerët,
- ✓ Vazhdimisht përkujdeset për zhvillimin e shkollës.



2. Ç'kuptojmë me shkollën e mirë?

Çështja e përcaktimit të shkollës së mirë është një çështje shumë komplekse dhe sfiduese. Ndodh shpesh që një drejtor shkolle mendon se ajo çfarë ata kanë arritur deri më tani është e mirë dhe e rëndësishme, por kjo ndoshta nuk është në pajtim me pritjet e mësimit dhe nxënësve apo komunitetit të gjerë. Mund të ndodhë që drejtori i shkollës të jetë mjaft i kënaqur me punën e shkollës, por një krahasim me shkollat tjera do të tregojë që ende “ka hapësirë për përmirësim”. Gjithashtu, drejtorët e shkollave shpesh edhe vetë mund të shohin nevojën për përmirësim, por nuk dinë se çfarë ata vetë mund të bëjnë rreth asaj: të presësh për një zgjidhje nga jashtë nuk është reagim adekuat pasi ka shumë përmirësime të mundshme që nuk përfshijnë buxhetin, por bazohen në një kuptim më të mirë të situatës, dijes dhe udhëheqjes, një ndryshim të proceseve të qëndrimeve.

Një shkollë e mirë është një vend ku fëmijët mësojnë gjëra të vlefshme, për të bërë një fillim të fortë në jetë, ku vendoset një themel që mbështet të mësuarit më vonë dhe ku fëmijët zhvillojnë dëshirën për të mësuar më shumë. Kjo i bën fëmijët të mendojnë për veten e tyre si njerëz që gjejnë forcë, ushqim dhe gëzim për të mësuar.



AKTIVITETI 1

- ➔ Bisedoni në grup për karakteristikat e një shkolle të mirë
- ➔ Listoni së paku 10 karakteristika të një shkolle të mirë
- ➔ Krahasoni karakteristikat e identifikuara me karakteristikat e një shkolle të mirë në tekstin që e keni në vijim.
- ➔ Nga karakteristikat për një shkollë të dhënë nga ju dhe nga 56 karakteristikat e paraqitura në tekst, dakordohuni dhe paraqitni 20 karakteristika të një shkolle të mirë.
- ➔ Prezentoni ato
- ➔ Nuk ndal zhvillimin e shkollës.

PESËDHJETË KARAKTERISTIKA TË NJË SHKOLLE TË MIRË¹

Një shkollë e mirë:

- 1 Përshtatet shpejt me ndryshimet shoqërore.
- 2 Përdor çdo burim, avantazh dhe mundësi që ka për të formuar nxënës dhe tenton të shohë më shumë burime dhe mundësi sesa shkollat me performancë më të ulët.
- 3 Ka nxënës që mirëkuptohen dhe mbështesin njëri - tjetrin drejt një qëllimi të përbashkët dhe ata e dinë se cili është ai qëllim.
- 4 Prodhon nxënës që lexojnë dhe shkruajnë, sepse ata dëshirojnë.
- 5 Pranon dështimet dhe kufizimet e saj, ndërsa punon sëbashku me një komunitet global për t'u ngritur.
- 6 Ka masa të ndryshme dhe tërheqëse të suksesit, masa që familjet dhe komuniteti i kuptojnë dhe vlerësojnë.
- 7 Është në dakordancë me nxënës që dinë se çfarë vlen të kuptohet.
- 8 Flet gjuhën e fëmijëve, familjeve dhe komunitetit që i shërben.
- 9 Përdor shkollat e tjera dhe organizatat kulturore.
- 10 E kupton mirë se merret në mes kuriozitetit, kërkimit dhe ndryshimit të duhur njerëzor.
- 11 Është e mbushur me nxënës që jo vetëm bëjnë pyetje të shkëlqyera, por e bëjnë me shumë frekuencë dhe pozitivitet.
- 12 Ndryshon nxënësit, nxënësit ndryshojnë në shkolla të mira.
- 13 E kupton ndryshimin midis një ideje të keqe dhe një zbatimi të keq të një ideje të mirë.
- 14 Përdor zhvillimin e vendosur profesional për të përmirësuar kapacitetin e mësimit me kalimin e kohës.
- 15 Nuk bën premtime boshe, nuk bën deklaratat mashtruese të misionit ose mashtron prindërit dhe anëtarët e komunitetit me zhargonin edukativ.
- 16 Është autentike dhe transparente.
- 17 Vlerëson mësimit dhe administratorët, bashkëpunëtorët e saj dhe prindërit si agjentë të suksesit të nxënësit,
- 18 Është e gatshme të ndryshojë mendje përballë trendeve, të dhënave, sfidave dhe mundësive përkatëse.
- 19 Mëson mendim, jo përmbajtje.
- 20 E bën vet teknologjinë, kurrikulën, politikën dhe pjesën e saj më pak të dukshme sesa nxënësit, shpresën dhe rritjen.
- 21 Përdor zhvillimin profesional për të përmirësuar kapacitetin e mësimit me kalimin e kohës.
- 22 Është prishëse e praktikave të këqija kulturore. Këto përfshijnë intolerancën e bazuar në racën, të ardhurat, besimin dhe preferencën seksuale dhe apatinë ndaj mjedisit.
- 23 Prodhon nxënës që e shohin dhe e njohin veten në kontekstin e tyre.

¹ The Characteristics Of A Good School, <https://www.teachthought.com/learning-models/the-characteristics-of-a-good-school-great-school/>

- 24 Prodhon nxënës që kanë shpresë personale dhe specifike për të ardhmen që ata mund t'i artikulojnë dhe besojnë dhe t'i ndajnë me të tjerët.
- 25 Prodhon nxënës që mund të empatizojnë, kritikojnë, mbrojnë, dashurojnë, frymëzojnë, bëjnë, projektojnë, rivendosin dhe kuptojnë pothuajse gjithçka dhe më pas e bëjnë këtë si një shprehje.
- 26 Do të lidhet me shkolla të tjera të mira dhe do të lidhë edhe nxënësit.
- 27 I ndihmon nxënësit të kuptojnë natyrën e njohurive, llojet e tyre, rrjedhshmërinë, përdorimet / abuzimet, aplikimet, mundësitë për transferim, etj.
- 28 Do të prodhojë nxënës që mund të mendojnë në mënyrë kritike.
- 29 Do t'i ndihmojë nxënësit të shohin veten e tyre në aspektin e formimit të tyre historik, trashëgimisë familjare, kontekstit shoqëror dhe lidhjes globale.
- 30 Dëshiron që të gjithë nxënësit të jenë 'në nivelin e klasave'
- 31 Ka një bibliotekë të shkëlqyeshme dhe një bibliotekar që i do nxënësit, që i pëlqen librat dhe që dëshiron që të dy të krijojnë lidhje domethënëse.
- 32 Ka hapësira krijuese dhe programe të mrekullueshme të arteve dhe shkencave humane, por më e rëndësishmja, këto lloje hapësirash mësimore karakterizohen nga studentët dhe idetë e tyre sesa nga programet' dhe vetë teknologjia.
- 33 Është plot gëzim, kuriozitet, shpresë, njohuri dhe ndryshime të vazhdueshme.
- 34 Pranon kur ka një problem në vend që ta fshehtë.
- 35 Nuk ka takime të panevojshme.
- 36 Nuk shpenzon para pa nevojë.
- 37 Promovon mësimin e bazuar në projekte, i do më shumë projektet dhe nxënësit që bëjnë projekte
- 38 Shpjegon rezultatet e testit me sinqeritet dhe në kontekst
- 39 Kurrë nuk heq dorë nga një nxënës dhe varet nga të menduarit krijues dhe zgjidhjet për nxënësit që i 'sfidojnë' ata.
- 40 Nuk ka frikë të kërkojë ndihmë.
- 41 E shih të ardhmen e të mësuarit dhe e bashkon atë me potencialin e së tashmes.
- 42 Nuk diplomon nxënës me pak ose aspak shpresë për të ardhmen.
- 43 Ndan njohuritë, të kuptuarit, aftësitë dhe kompetencat dhe i ndihmon nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë.
- 44 'Lëviz' nxënësit e talentuar po aq 'larg' sa lëvizin nxënësit që përpiqen (që kanë vështirësi),
- 45 Përfiton nga burimet e nxënësve të saj dhe familjeve të tyre
- 46 Nuk i lodh mësimdhënësit dhe administratorët.
- 47 Ndihet mirë që të gjithë vizitorët mund të mësojnë nga ajo, të japin mësim brenda, të shkëmbejnë përvojën.
- 48 Kërkon të formojë mësimdhënës të shkëlqyeshëm që kërkojnë të formojnë të gjithë nxënësit për të ndryshuar botën e tyre.
- 49 Përcjellë risitë në të gjitha fushat e jetës
- 50 Nuk ndalon së vepruari për të mirën e nxënësit në asnjë rrethanë.

2.1. Çfarë e bën shkollën një shkollë të mirë bazuar në dokumentet e MASH

Me qëllim të krijimit të një Sistemi të qëndrueshëm dhe të besueshëm të Sigurimit të Cilësisë në Sektorin e Arsimit Parauniversitar të Kosovës, MASH-i me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit zhvilloi një Strategji për Sigurimin e Cilësisë 2016-2020.² Kjo strategji mbulon në detaje pesë fushat e sigurimit të cilësisë. Përveç Strategjisë, MASH-i, gjithashtu, ka hartuar një doracak për sigurimin e cilësisë për të ndihmuar shkollat dhe komunat në zbatimin e kësaj Strategjie.

Profili i një shkolle të suksesshme dhe të orientuar drejt cilësisë lidh fushat e cilësisë së shkollës, të cilat janë pikat e referimit që e bëjnë një shkollë të mirë. Këto fusha të cilësisë janë ri-dizajnuar në vitin 2016, bazuar në rekomandimet e raporteve të punëtorive të ndryshme, reformave të arsimit dhe prioritetëve të arsimit të përcaktuara në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021³.

Për më tepër, MASH-i së bashku me Institutin Pedagogjik kanë zhvilluar Kornizën e Sigurimit të Cilësisë për Vlerësimin e Performancës së Shkollave kundrejt këtyre pesë fushave të cilësisë:

- Qeverisja dhe menaxhimi
- Kultura dhe mjedisi shkollor
- Mësimdhënia dhe mësimnxënia
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve
- Performanca e nxënësve.

Bazuar në Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë 2016-2020, këto fusha të cilësisë mbulojnë të gjitha aspektet që çojnë në një shkollë të mirë. Jepni pjesëmarrësve Kornizën për Vlerësimin e Performancës së Shkollave (MASH, 2016), e cila përshkruan në hollësi secilën prej fushave të cilësisë. (Shih Shtojcën B).

AKTIVITETI 2

Disa nga fushat e cilësisë së përmendur janë duke u prezantuar dhe diskutuar në module të veçanta të këtij trajnimi. Gjithashtu, mund të ndodhë që fushat e njëjta të cilësisë të përmenden në module të ndryshme, gjë që është e arsyeshme pasi që të gjitha janë të lidhura me udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollës. Fushat e cilësisë që do të trajtohen në këtë modul janë:

- Mësimdhënia dhe mesimnxënia
- Performance e nxënësve
- Kultura dhe mjedisi shkollor

² Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2016) Strategjia e Sigurimit të Cilësisë 2016-2020

³ Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2016): Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

3. Të nxënit dhe mësimdhënia

3.1 Të nxënit?

Përderisa aftësitë akademike dhe njohëse janë të rëndësishme, me qëllim që t'u përgjigjemi nevojave të botës post-moderne të diversitetit, inovacionit, teknologjisë dhe ndryshimeve mjedisore, agjenda e re e arsimit fokusohet gjithashtu në të nxënit për të krijuar, zgjidhur problemet, menduar në mënyrë kritike, për të mësuar si të mësohet dhe për t'u kujdesur për të tjerët dhe mjedisin (Stoll dhe të tjerët 2002). Shkathësitë e shekullit të 21-të janë esenciale për ekonominë e re - ku kuptimi i të mësuarit është zgjeruar nga thjesht duke u lidhur me njohuritë akademike në njohuri më të përgjithshme dhe duke i përgatitur fëmijët për jetën e të qenit të rritur – të cilat shkathësi promovojnë gjithashtu edhe virtytet, vlerat dhe qëndrimet (KKK, MASH 2016). Për më tepër, të nxënit shihet dhe kërkohet në tërësinë e tij dhe zhvillohet: në klasë, në shtëpi, në komunitet, në natyrë, në hapësirën kibernetike, në bibliotekë dhe në projekte të tjera (Korniza për Sigurimin e Cilësisë në Performancën e Shkollës, MASH 2016). Ndërsa, roli i mësimdhënësit është që të jetë një lehtësues që mbështet këtë lloj mësimi.

Ekzistojnë përkufizime të shumta përkitazi me të nxënit⁴

- ✓ Të nxënit është proces i pavarur, është proces intelektual i individit (nxënësit), është aktivitet intelektual e psikomotorik me anën e të cilit përvetësohen dituri, shkathësi e shprehje të cilat ndryshojnë sjelljet e përgjithshme. Ai është “proces aktiv dhe i pavarur i secilit që nxë dhe si i këtillë konsiderohet se është faktori kryesor i ndryshimit të veprimtarisë së individit.”
- ✓ “Të nxënit është një ndryshim i brendshëm në një person, formimi i lidhjeve të reja ose potenciali për reagime të reja. Të nxënit është kështu një ndryshim i qëndrueshëm në aftësitë e një personi. Ky përcaktim pranon se të nxënit është proces që ndodh brenda një personi (pikëpamja kognitive), por gjithashtu thekson rëndësinë e ndryshimeve në sjelljen e vëzhgueshme si tregues që të nxënësit ka ndodhur (pikëpamja biheivioriste).

⁴ Zabeli, N., & Hoti, D. (2013). Aspekte pedagogjike dhe strategji ndërvepruese të mësimdhënies. Prishtinë: Norwegian Embassy.

Si ndikojnë teoritë në procesin e të nxënit dhe në mësimdhënie?

Përkitazi me të nxënit ekzistojnë me shume teori. Në pamundësi që t'i trajtojmë te gjitha, në vijim do t'i paraqesim disa nga ato:

Teoria konstruktiviste

Bazohet kryesisht në përvojë. Premisa themelore është se *“duke reflektuar në përvojën tonë ne e ndërtojmë të kuptuarit e botës në të cilën jetojmë”*. *Çdo person gjatë jetës së tij, gjeneron:*

- rregulla te caktuara veprimi,
- modele mendore personale nga aspekti i dobisë që ato paraqesin,
- begaton vazhdimisht përvojat e tij,
- gjatë viteve i gjeneralizon përvojat e fituara në probleme të reja,
- i përshtatë ato në modele të reja të të nxënit në përditshmëri.

Teoria bihevioriste

Bazohet në *sjelljet që mund të vështrohen në mënyrë objektive*. Nxënien e e shpjegojnë kryesisht si *“përvetësim i sjelljeve të reja”*. Sipas përfaqësuesve të kësaj teorie përvetësimi i sjelljeve të reja do të ishte shumë më lehtë të bëhej duke u mbështetur në kushtëzimin instrumental. Me këtë rast kushtëzimi konsiderohet proces universal i nxënies dhe se përmes kushtëzimit “imponohet” modeli përkatës i cili, pas shumë përsëritjeve, përvetësohet.

Nga psikologjia rezultojnë dy rrugë të përshtatshme për kushtëzimin:

Si ndikon biheviorizmi në të nxënë ?

- Është teori relativisht e thjeshtë;
- Mbështetet në sjelljet e vëzhgueshme;
- Përshkruan disa ligjshmëri universale të sjelljes;
- Ecuritë e saj pozitive dhe negative mund të jenë të efektshme edhe te njerëzit e edhe te kafshët.
- Ofron mundësi kurative në rastet e njerëzve artist ose te ata me sjellje asociale.

SHEMBULL:

Mësimdhënësit e zbatojnë bihevizorizmin në rastet kur i shpërblejnë ose i ndëshkojnë sjelljet përkatëse të nxënësve të tyre.

Teoria kognitiviste

Bazohet në idenë se *“fëmija në zhvillim (në proces, ecje kronologjike e moshore) ndërton struktura kognitive (harta mendore, skema, koncepte të rrjetëzuara etj.) për të kuptuar dhe për t’iu përgjigjur përvojave fizike (kimike e biologjike) në botën që e rrethon (ambientin e tij të ngushtë e më vonë edhe atë të gjerë). ”*

Si ndikon kognitivizmi në të nxënë ?

Kognitivizmi si filozofi në nxënie shprehet veçanërisht në kurrikuli- bazën programore, sepse përmbajtjet kërkohet të renditen në një aspekt tjetër për të ndryshuar mësimdhënia dhe për të arritur rezultatet më të favorshme, si vijon:

Kurrikula

- Nga mësimdhënësit kërkohet të planifikojnë kurrikulë adekuate sipas staveve të zhvillimit të fëmijës;
- Të përpilojnë përmbajtje logjike të cilat fëmijët “ i shtynë ” të mendojnë në mënyrë aktive;
- Të përmirësojnë rritjen logjike dhe konceptuale të nxënësve.

Mësimdhënia:

- Theksimi i rolit kritik të përvojave;
- Kujdesi i mësimdhënësit për rëndësinë e ndërveprimit me rrethin e nxënies të nxënësit;
- Evidentimi i rrugëve e modeleve të shumta varësisht sipas afiniteteve të secilit nxënës.

Vlerësimi:

- Vlerësimi bëhet pjesë e procesit të nxënies;
- Vlerësimi i progresit të nxënësit konkret sipas modelit ose modeleve të cilat ai i shprehë.

Teoria humaniste

Teori e të nxënit që synon të udhëzojë nxënësit drejt rritës së tij si personalitet " i tërë" në tërë tonalitetin e tij fizik, mendor, emocional, moral etj.

Teoria e inteligjencave të shumëfishta të Gardner-it e mbështet humanizmin.

Qëllim themelor është - vetaktualizimi, sipas së cilës "personi zbulon interesimet e tij personale dhe potencialet e tij si individ".

Si ndikon humanizmi në të nxënë ?

Kurrikula

- Nuk theksohet zotërimi i fakteve;
- Nuk theksohet memorizimi mekanik i përmbajtjeve;
- Kërkohet ofrimi i mundësive për të kuptuar dhe motivimi i fëmijëve - " të mendojnë;
- Ofrimi i më shumë mundësive dhe vënia e subjektit në pozitën që të zgjedh"
- Zhvillimi i shkathtësive të të menduarit kritik.

Mësimdhënia:

- Formimi i ndjenjës për" identitet personal";
- Theksimi i rolit të vetëvlerësimit;
- Respektimi i interesimeve dhe orientimeve të nxënësit

Vlerësimi:

- Vlerësimi bëhet pjesë e procesit të nxënies duke shkëmbyer idetë singlerisht me nxënësit;
- Krijimi i raporteve autentike e spontane.

AKTIVITETI 3

Pas diskutimit për procesin e të nxënit dhe teorinë, diskutoni në grup si ndikojnë teorinë në procesin e të nxënit.

- ➔ Çfarë konsideroni se në shkollën tuaj krijon vështirësi në të nxënë te nxënësit tuaj?
- ➔ Çilët janë shkaqet dhe cilat janë mundësitë për përmirësimin e procesit të nxënit?
- ➔ Çfarë duhet të ndërmerri ju si drejtor shkolle, për të përmirësuar procesin dhe rezultatet e të nxënit?

3.2. Mësimdhënia cilësore

Mësimdhënia cilësore është ajo mësimdhënie që lehtëson me forma, metoda, teknika dhe strategji të përshtatshme procesin e të nxënimit të nxënësve. Mësimdhënien duhet kuptuar si një akt bashkëveprimi, dinamik, fleksibël, të hapur midis mësimdhënësit dhe nxënësit, nxënësve midis tyre, ku të gjithë kanë të drejtë të marrin vendime dhe role të përshtatshme .

Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton ndryshimin e roleve të mësimdhënësit dhe nxënësit, pjesëmarrje të komunitetit në jetën e shkollës dhe të shumë faktorëve të tjerë arsimor.

Mësimdhënia bashkëkohore është ajo që lehtëson të nxënimit e nxënësve përmes strategjive të përshtatshme. Ajo priret nga parime si më poshtë:

- ✓ Zhvillon aftësitë e nxënësve për të realizuar një të nxënë të pavarur
- ✓ Zhvillon iniciativë dhe pavarësi
- ✓ Nxit diversitetin në të nxënimit e nxënësve dhe kreativitetin e tyre
- ✓ Zhvillon aftësi më të mira komunikative
- ✓ Zhvillon aftësi menaxhuese, organizuese
- ✓ Nxit vetëvlerësim dhe vlerësim të përshtatshëm rreth rezultateve mësimore të nxënësve.

Baza për një kulturë të nxënimit është njohuria mbi mësimdhënien profesionale. Rezultatet e reja shkencore rreth trurit tonë njerëzor ndihmojnë për të kuptuar se si ndodh të mësuarit dhe çfarë ne duhet pasur parasysh gjatë mësimdhënies. Kështu që mësimdhënësit duhet të profesionalizohen vazhdueshëm në fushat e mësimdhënies dhe të nxënimit, duke u bazuar në të dhënat dhe rezultatet shkencore si dhe në trendët më të fundit.

Me qëllim të krijimit të një kulture të të nxënimit cilësor është gjithashtu jetike thelbësore që të përmirësohet performanca individuale e mësimdhënësit sa i përket objektivave të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës (2016).⁴ Përveç kësaj, shkolla gjithashtu mund të ndihmojë për t'a bërë më atraktive dhe më praktike përvojën dhe të nxënimit në shkollë përmes një kurrikulumi kreativ t, që u ofron nxënësve më shumë mundësi të mësojnë lëndët e lidhura me nevojat e tregut global dhe të vendit ku ata jetojnë, urban apo rural. Një kulturë e të nxënimit mund të rritet më tutje nëse sistemi arsimor ofron arsim joformal (apo të bazuar në shkathësi) për braktisësit e hershëm të shkollës, sikur që janë shkathësitë teknike të lidhura me punën.

AKTIVITETI 4

→ Diskutoni në dyshe disa karakteristika të mësimdhënësit efektiv.

→ Listoni së paku pesë karakteristika të një mësimdhënësi efektiv.

→ Lexoni dhe identifikoni ato pesë karakteristika nëse gjenden në tekstin në vijim: Njëzetë karakteristika të vëzhgueshme të mësimdhënies efektive – mësimdhënësi efektiv.

Mendoni këto karakteristika dhe tregoni (për shkollën tuaj) sa mësimdhënës i posedojnë dhe sa nuk i posedojnë këto karakteristika. Paraqitni ide çfarë mund të bëni ju për t'i arritur ato.

3.3 Njëzetë karakteristika të vëzhgueshme të mësimdhënies efektive – mësimdhënësi efektiv⁵

Mësimdhënësit e suksesshëm janë ata që kanë aftësinë për të maksimizuar potencialin e të nxënësve të gjithë nxënësve në klasën e tyre. Zhvillimi i marrëdhënieve pozitive ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit është një aspekt themelor i mësimdhënies cilësore dhe mësimi të nxënësve. Marrëdhëniet pozitive mësimdhënës-nxënës inkurajojnë nxënësit që të marrin pjesë në mënyrë bashkëpunuese dhe u mundësojnë mësimdhënësve që të përshtatin mësimdhënien e tyre me nevojat specifike të nxënësve individualë në klasat e tyre. Nxënësit zhvillojnë besim për të eksperimentuar dhe arritur sukses në një mjedis ku nuk janë të kufizuar nga frika e dështimit.

- 1 Fillon mësimdhënien menjëherë dhe në një mënyrë të mirë-organizuar.
- 2 Trajton nxënësit me respekt dhe kujdes.
- 3 Siguron rëndësinë e informacionit që duhet të mësohet.
- 4 Jep shpjegime të qarta. Mban vëmendjen dhe respektin e nxënësve, praktikon menaxhim efektiv të klasës.
- 5 Përdor të nxënësit aktiv, praktik të nxënësve.
- 6 Ndryshon vazhdimisht teknikat e mësimdhënies.

⁵ 20 Observable Characteristics Of Effective Teaching, <https://www.teachthought.com/pedagogy/20-observable-characteristics-of-effective-teaching/>

- 7 Siguron pritje të qarta, specifike për detyrat.
- 8 Siguron reagime të shpeshta dhe të menjëhershme për nxënësit për performancën e tyre.
- 9 Vlerëson përgjigjet e nxënësve dhe përdor pyetjet e shtruara për të sqaruar, përpunuar përgjigjet.
- 10 Ofron shumë shembuj praktik, konkret nga jeta reale.
- 11 Nxjerr përfundime nga shembuj, modele dhe përdor analogji.
- 12 Krijon një ambient të klasës i cili është i rehatshëm për nxënësit, u lejon atyre të flasin lirshëm.
- 13 Mëson me një ritëm të shpejtë të duhur, duke ndaluar për të kontrolluar mirëkuptimin dhe angazhimin e nxënësit.
- 14 Komunikon në nivelin e të gjithë nxënësve në klasë.
- 15 Ka një sens humori.
- 16 Përdor sjellje joverbale, të tilla si gjeste, ecje përreth dhe kontakte me sy për të përforcuar komentet e tij/saj.
- 17 E paraqet veten në klasë si njeri të vërtetë .
- 18 Përqendrohet në objektivin e klasës dhe nuk e lë klasën të hiqet mënjanë.
- 19 Përdor reagimet e nxënësit për të vlerësuar dhe përmirësuar mësimdhënien.
- 20 Reflektton mbi mësimet vetanake për t'u përmirësuar.

3.4 Cilat janë synimet e arsimit?

Vizioni i arsimit në Kosovë (siç promovohet nga Korniza e Kurrikulës së Kosovës) është që të mundësojë që personi të bëhet i pavarur, i aftë për të përmbushur jetën e tij personale dhe për të kontribuar në progresin, prosperitetin dhe mirëqenien e vazhdueshme të shoqërisë kosovare. Synimet kryesore që dalin nga ky vizion janë:

- ✓ Zhvillimi i identitetit fleksibil, të shumëfishtë të përkatësisë kombëtare dhe kulturore;
- ✓ Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;

- ✓ Zhvillimi i përgjegjesisë për veten, për të tjerët, për shoqërinë dhe për mjedisin;
- ✓ Përgatitja për jetën dhe punën në kontekstin e ndryshimeve sociale dhe kulturore;
- ✓ Zhvillimi i sipërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë
- ✓ Përgatitja për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Kompetencat dhe rezultatet përfundimtare (që merren në fund të arsimit të detyrueshëm)

Në përputhje me vizionin e arsimit të Kosovës dhe politikat që mbështesin Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, në vijim janë kompetencat kryesore të parashikuara për sistemin arsimor të Kosovës:

3.5. Korniza e Kurrikulës të Kosovës: Përgatitja për ndryshim

Korniza e Kurrikulës së Kosovës është ndërtuar mbi pesë parimet e reja që kanë për qëllim të përmirësojnë gradualisht atë që tashmë jeni duke bërë në klasën tuaj.

- 1 Gjithëpërfshirja: Çdo fëmijë ka të drejtën për arsim cilësor
- 2 Qasja e bazuar në kompetenca;
- 3 Mësimdhënie dhe mësimnxënie e integruar dhe koherente;
- 4 Rritja e autonomisë dhe fleksibilitetit në nivel shkollë;
- 5 Përgjegjësia dhe llogaridhënia.

Drejtorët e shkollave duhet të fillojnë të përgatiten dhe të mbështesin mësimdhënësit e tyre për ndryshimet e kërkuara nga Kurrikula e re e Kosovës 2016, pasi që zbatimi i saj do të fillojë në të gjitha shkollat nga viti akademik 2017-2018. Me qëllim të mbështetjes së zbatimit të saj, MASH-i do të rishikojë/zhvillojë tekstet shkollore dhe në këtë mënyrë do të përgatisë shkollat dhe mësimdhënësit për zbatimin e kurrikulës së re të bazuar në kompetenca, e cila është rishikuar në vitin 2016 pas zbatimit të saj në një numër shkollash.

AKTIVITETI 4

Komentoni pesë parimet themelore të KKK. Formohen pesë grupe (secili grup një parim) dhe secili grup jep përgjigje: Cfarë domethënie kanë këto dhe si duhet të realizohen në praktikë?

3.5.1 Kurrikula e Kosovës- elementet themelore

Kurrikula e Kosovës përkufizohet si sistemi i tërë dokumenteve të Kurrikulës që përcakton llojin dhe nivelin e rezultateve të pritura në lidhje me atë që do të mësohet në shkollë, dhe përshkruan çfarë, kur, si (në kuptimin e përgjithshëm pedagogjik) do të ndodhë kjo. Kurrikula e Kosovës rregullon procesin e përgjithshëm të të mësuarit në arsimin e detyrueshëm të Kosovës.

Kurrikula e Kosovës është e strukturuar në dy komponentë kryesorë:

Komponenti Konceptual - i përfaqësuar nga Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK)

- ✓ KKK-ja merr parasysh ndryshimet e shumta në sistemin arsimor që nga zhvillimi i kurrikulës së vitit 2001, si dhe sfidat e reja të identifikuar gjatë periudhës 2001 - 2016. Këto sfida kërkojnë që të rinjtë të zhvillojnë aftësinë për të përdorur njohuritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet në kontekstin e zgjidhjes së problemeve në botën reale dhe në këtë mënyrë të arrijnë kompetencat e dëshiruara siç artikulohe në KKK.

Komponenti Operativ i përfaqësuar nga:

- ✓ Kurrikula Bërthamë e Kosovës (KBK 2016) për nivelet e arsimit zyrtar (fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë)
- ✓ Programi i lëndëve indikative për klasat 1 - 12
- ✓ Dokumentet mbështetëse: tekstet shkollore, materialet mësimore dhe të nxënies, udhëzuesit e mësimdhënësve, softueri arsimor dhe CD-të, materialet e vlerësimit dhe provimit, instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit të sigurimit të cilësisë.

Jashtëzakonisht është e rëndësishme që drejtorët e shkollave të luajnë një rol aktiv duke i ndihmuar mësimdhënësit për t'u përgatitur për këto ndryshime të ardhshme dhe të jenë në gjendje të menaxhojnë sfidat e reja, duke përfshirë qasje të reja në metodologjitë, materialet mësimore dhe të nxënies, vlerësimin e nxënësve dhe çështjet e ndërlydhura si dhe praktikën e gjithëpërfshirjes. Drejtorët e shkollave duhet t'u ndihmojnë mësimdhënësve që të zhvillojnë praktikën aktuale të mësimdhënies për të përmbushur pritjet e reja. Kurrikula e re synon të jetë më e harmonizuar me zhvillimet ndërkombëtare të kurrikulave, kërkesat dhe standardet e OBEZh-it, e cila është një tjetër sfidë me të cilën duhet të merren drejtorët e shkollave dhe stafi i tyre shkollore. Duke pasur parasysh rezultatet e PISA-s në Kosovë në vitin 2015, drejtori i shkollës duhet të përfshihet më shumë se kurrë në rezultatet e të nxënies të secilës lëndë, me fokus në ato lëndë që vlerësohen nga OBEZh-i si më të rëndësishme për Zhvillimin Ekonomik (Shkencë, Matematikë dhe Shkrim-Lexim) dhe vazhdimisht të mbështes mësimdhënësit në arrijtjet e tyre. Bazuar në raportin e OBEZh-it të vitit 2016, të dhënat nga PISA 2015 tregojnë se sistemet arsimore ku drejtorët e shkollave janë më të përgjegjshëm dhe të përfshirë në udhëheqjen e shkollës, nxëniesit arrijnë rezultate më të mira në shkencë.




Figura 3.1. Kompetencat e Kurrikulës së Kosovës

3.6. Fazat kyçe të Kurrikulës

Korniza e Kurrikulës së Kosovës është e strukturuar në faza kryesore të kurrikulës të cilat janë në përputhje me strukturën arsimore të arsimit parauniversitar në Kosovë.

Fazat janë periudha të definuara prej 1-3 vite. Fazat e kurrikulës përcaktojnë kërkesat e kurrikulës si dhe qasjet e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në fund të çdo faze të kurrikulës, Kurrikula Bërthamë do të përcaktojë grupin e:

- ✓ Kompetencave kryesore që duhet të arrihen;
- ✓ Kërkesave për progres;
- ✓ Strukturave për organizimin e përvojave mësimore dhe të nxënit;
- ✓ Qasjeve të vlerësimit dhe kritereve të vlerësimit.

Hartimi i kornizës së kurrikulës sipas fazave reflekton nevojën për:

- ✓ Më shumë transparencë dhe qartësi në artikulimin e qëllimeve dhe detyrave të arsimit;
- ✓ Mundësinë e udhëzimeve konkrete për organizimin e aktivitetit shkollor me theks në metodat specifike, rezultatet/objektivat dhe mjetet e vlerësimit;
- ✓ Pranimin e karakteristikave specifike të fazave të zhvillimit dhe të synimeve specifike të secilës fazë kyçe të kurrikulës; dhe
- ✓ Nevojën për të rritur llogaridhënien e shkollës për cilësinë e arsimit të ofruar në nivel shkolle dhe progresi i nxënësve në zhvillimin e kompetencave kyçe.

Grafiku i mëposhtëm paraqet një pasqyrë të gjerë të fazave kryesore të kurrikulës:




Figura 3.2 Fazat e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës

3.7. Roli i veçantë i mësimit dhe të nxënësve

Procesi i mësimit dhe të nxënësve ka rëndësi kuptimplote për të zhvilluar një shkollë të mirë dhe të suksesshme. Në studimet e ndryshme ndërkombëtare roli i mësimit dhe të nxënësve duket të jetë element qendror për të arritur rezultate të mira dhe përfundime të suksesshme, të cilat janë të dy faktorë të rëndësishëm të një shkolle të mirë.

Helmke hulumtoi faktorët e mësimit dhe të nxënësve të suksesshëm. Rezultatet e studimit të tij të gjerë ishin 10 fusha të mësimit dhe të nxënësve cilësor që mund të konsiderohen edhe si 10 faktorë të një shkolle të mirë:

Pjesëmarrësit e trajnimit të udhëheqjes arsimore pritjet që t'i arrijnë rezultatet themelore si në vijim:

1. Menaxhimi i klasës
2. Qartësia dhe struktura e mësimit dhe të nxënësve
3. Kujdesi dhe konsolidimi
4. Aktiviteti i nxënësve
5. Motivimi
6. Klima përkrahëse e klasës
7. Fokusi në nxënësin individual
8. Fokusi në kompetenca
9. Trajtimi i heterogjenitetit
10. Ofrimi i ambienteve të ndryshme për mësimit dhe marrëveshjeve për mësimit

MENAXHIMI I KLASËS nënkupton jo vetëm rregullat e sjelljes, por gjithashtu rolin e një mësimitdhënësi si trajner, këshilltar dhe përkrahës në mësim. Ai ose ajo është përgjegjëse që çdo nxënës të ketë të drejtën e të mësuarit në orën e mësimit. Kështu që menaxhimi i klasës nënkupton gjithashtu mënyrën se sa efektivisht mësimitdhënësit shfrytëzojnë kohën e tyre në një orë mësimore dhe si ata i menaxhojnë pengesat gjatë orës.

QARTËSIA DHE STRUKTURA E MËSIMDHËNIES nënkupton se si mësimitdhënësit paraqesin dhe ua mësojnë përmbajtjet nxënësve dhe si ata i strukturojnë orët e tyre mësimore, por gjithashtu edhe procesin e mësimitnxënies për nxënësit. Të gjitha metodat, komunikimet dhe përmbajtjet duhet të jenë të qarta, të rregullta dhe të kuptueshme për të gjithë nxënësit. Nxënësit duhet të dinë se çka janë duke mësuar dhe si do t'u shërbejnë këto mësimore atyre në jetë.

KUJDESI DHE KONSOLIDIMI përshkruan nevojën e ushtrimit efektiv.

AKTIVITETI I NXËNËSVE ka si objektiva aktivitetin njohës, emocional, social, fizik dhe praktik të nxënësve. Shembuj të aktiviteteve të nxënësve janë: format bashkëpunuese të mësimitnxënies, reflektimi i mësimitnxënies dhe të nxënësve vetëprues.

MOTIVIMI si një faktor qendror i punës dhe mësimitnxënies aktive nënkupton që detyrat duhet të kenë sfida dhe të ngjallin kureshtjen e nxënësve. Për më tepër nxënësit duhet të kontrollojnë procesin e tyre të mësimitnxënies dhe duhet angazhuar fantazinë dhe kreativitetin. Motivimi gjithashtu ka nevojë për transparencë dhe qartësi të pritjeve të mësimitdhënëseve.

KLIMA PËRKRAHËSE E KLASËS nënkupton kulturën e mësimitnxënies në një klasë, por gjithashtu edhe nivelin e kënaqshmërisë së nxënësve, mësimitdhënëseve dhe prindërve me procesin dhe rezultatet e mësimitnxënies. Mënyra sesi të përballemi pozitivisht dhe në mënyrë efektive me gabimet paraqet një element të rëndësishëm të një klime përkrahëse të klasës. Vlerësimi për për të Nxënës (Vlerësimi Formativ) promovon klimën mbështetëse në klasë.

FOKUSI NË NXËNËS INDIVIDUAL nënkupton që i gjithë procesi i mësimitdhënies dhe mësimitnxënies duhet t'u përshtatet nxënësve, moshës së tyre, nivelit të njohurive, mjedisve dhe interesave. Gjatë përgatitjes së orëve mësimore është e nevojshme që mësimitdhënësit të dijnë shumë rreth nxënësve të tyre dhe të dijnë sesi t'i motivojnë dhe aktivizojnë ata. Në këtë mënyrë, mësimitdhënësit informohen edhe sa i përket mënyrës së mësimitdhënies si dhe të nxënësve të tyre. Mësimitnxënja e diferencuar promovon mësimin e bazuar në nevojat individuale.

FOKUSI NË KOMPETENCA nënkupton që standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të arsimit janë objektiva të mësimitdhënies. E gjithë kurrikula e shkollës duhet të organizohet në standarde të kompetencave, të cilat do të mund të testoheshin dhe vlerësoheshin. Duke qenë se Kurrikula e Re e Kosovës është e bazuar në këto standarde ndërkombëtare, mësimitdhënësit duhet t'i harmonizojnë mësimet e tyre me rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në Kurrikulën e Re.

TRAJTIMI I HETEROGJENITETIT bëhet gjithnjë e më shumë një fokus special në shkollë. Në ditët e sotme, ne e dimë që heterogjeniteti dhe individualiteti janë elemente normale të shoqërive. Zakonisht në shumë klasa ka nxënës me të kaluar të ndryshme sociale, ekonomike dhe kulturore, religjione, gjuhë amtare, gjini, orientim seksual, etj. Prandaj është e nevojshme të individualizohet procesi i mësimitdhënies dhe mësimitnxënies.

OFRIMI I AMBIENTEVE TË NDRYSHME PËR MËSIM DHE MARRËVESHJEVE PËR MËSIM me lloje të ndryshme të udhëzimeve janë rezultat i trajtimit efektiv të heterogjenitetit dhe individualizmit. Ne e dijmë nga studimet shkencore që mësimi është proces vetëveprues i çdo personi, i cili ka nevojë për përvoja, aktivitete, motivim dhe reflektim. Ambienti për mësim provon të rregullojë proceset e tilla ku nxënësit mësojnë vetëveprimin, vetëreflektimin dhe vetëpërgjigjen.

Me qëllim të realizimit dhe arritjes së këtyre faktorëve të mësimdhënies dhe mësimnxënies, është e nevojshme të kualifikohen mësimdhënësit. Roli i një mësimdhënësi ka ndryshuar gjatë viteve të fundit. Nëse një shkollë dëshiron të jetë e mirë dhe e suksesshme ajo ka nevojë për mësimdhënës profesional, të cilët veprojnë si këshilltarë, trajner në mësim dhe mentor për nxënësit. Ky është gjithashtu rezultat i një studimi të John Hattie, 2009. Mësimdhënësi është faktori më i rëndësishëm i një shkolle të mirë dhe arsimimi të mirë.

Se mësimdhënësit e kualifikuar dhe të përgatitur mirë, të cilët janë të gatshëm të ndryshojnë dhe të zhvillohen gjatë gjithë shtegut të karrierës së tyre, kontribuojnë në një mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore, është gjithashtu e dukshme edhe në kontekstin e Kosovës. Për më tepër, rezultatet e PISA 2015 tregojnë se zhvillimi profesional i mësimdhënësve është më pak i organizuar në Kosovë se në shumicën e vendeve të tjera. Me zbatimin e kurrikulës së re, mësimdhënësit e Kosovës më shumë se kurrë duhet të angazhohen në zhvillimin profesional që do t'i zhvillojë aftësitë e tyre në mësimdhënie e kurrikulave të reja të bazuara në kompetenca. Për të optimizuar zbatimin efektiv të kurrikulave dhe për t'i motivuar mësimdhënësit që t'i përshtatin praktikatat e tyre të mësimdhënies, mësimdhënësit duhet të pajisen me materiale mësimore, duke përfshirë tekstet shkollore që përputhen me pritjet e kurrikulës.

Në përputhje me reformat arsimore dhe rëndësinë e rritjes së aftësive dhe njohurive të mësimdhënësve, MASH-i ka zhvilluar Kornizën e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve, e përbërë nga gjashtë standarde, në të cilat bazohet performanca e mësimdhënësve:

- 1 Zotimi ndaj nxënësve dhe mësimnxënies së tyre
- 2 Njohuritë profesionale
- 3 Mësimdhënia
- 4 Bashkëpunimi me kolegët, prindërit dhe komunitetin
- 5 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional
- 6 Përgjegjësia ndaj detyrave dhe obligimeve në punë

Qasja e ZhPM-së e futur në zbatim në shkollat e Kosovës është në përputhje me kërkesat e Kornizës së MASH-it të Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve, siç përmendet në Udhëzimin Administrativ (16/2013, MASH), i cili përcakton se rolet dhe përgjegjësitë e MASH-it janë *‘të mbështes zhvillimin e programeve të reja duke adresuar nevojat kombëtare dhe ato të mësimdhënësve*. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë zbatohet nga ofruesit e jashtëm dhe nga ofrimi i trajnimeve me bazë në shkollë. Me politikat e reja për licencimin e mësimdhënësve (UA 25/2014, MASH)⁶ dhe vlerësimin e performancës së mësimdhënësve (UA 14/2013)⁷, mësimdhënësit duhet të ndjehen më të motivuar që vazhdimisht të mësojnë dhe t'i zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe personale. Për më tepër, mësimdhënësit duhet të përfundojnë 100 orë të zhvillimit profesional gjatë pesë viteve dhe të demonstrojnë performancë pozitive në mënyrë që ta përtërijnë licencën e tyre.

3.8 Çka do të thotë e gjithë kjo për drejtorët e shkollave?

Tre faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në të nxënëit e fëmijës janë: angazhimi prindëror; cilësia e mësimdhënies dhe udhëheqja. Sidoqoftë, udhëheqja konsiderohet vendimtare për të siguruar që këto tre komponente të punojnë së bashku në harmoni (Mullford, 2008). Kurrikula e re siguron një nivel më të lartë të autonomisë shkollore për të planifikuar dhe realizuar zbatimin e saj në përputhje me kushtet specifike të personelit të saj mësimor, infrastrukturës shkollore dhe karakteristikave të tjera lokale ku vepron shkolla. Si e tillë, është përgjegjësi e drejtorit të shkollës për të siguruar që zbatimi i planit zhvillimor të shkollës dhe vlerësimi i performancës shkollore, të cilat janë të kërkuara me ligj, të zbatohen duke plotësuar pesë fushat e cilësisë sipas standardeve më të larta të mundshme në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Në këtë kontekst, shkollat priten të shqyrtojnë me kujdes pikat e forta dhe të dobëta të secilit prej mësimdhënësve të tyre, në mënyrë që të ndërmarrin hapat e duhur për personelin e tyre mësimor. Mësimdhënësit priten të përdorin më shumë fleksibilitetin e tyre për të planifikuar dhe përdorur një gamë të gjerë të metodologjive të mësimdhënies, të përshtatshme për një qasje interaktive dhe të individualizuar të nxënësve drejt arritjes së rezultateve mësimore të paracaktuara.

Roli i drejtorit të shkollës është që të sigurojë udhëheqje dhe menaxhim duke ushtruar stilin e udhëheqjes mësimore, ku fokusi kryesor është mësimi nga ana e nxënësve përmes përmirësimit të mësimdhënësve.

Tre dimensionet e udhëheqjes instruktive të cilat janë propozuar nga Hallinger (2003) dhe që kanë ndikim në rezultatet e nxënësve janë:

- 1 Përkufizimi i misionit të shkollës;
- 2 Menaxhimi i programit të mësimdhënies; dhe
- 3 Promovimi i një klime pozitive të mësimnxënies në shkollë

6 Ministria e Arsimit dhe Shkencës: UA 25/2014 Licencimi i Mësimdhënësve

7 Ministria e Arsimit dhe Shkencës: UA 14/2013 Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve



Nga ana tjetër, duke qenë se Kosova gjatë viteve të fundit ka përjetuar reforma thelbësore arsimore me kurrikulën e re moderne dhe sistemin e arsimit të decentralizuar, kombinimi i stilit të udhëheqjes instruktive me stilin e udhëheqjes transformuese është një qasje e arsyeshme. Udhëheqja transformuese është e fokusuar në ndërtimin e ekipeve bashkëpunuese dhe ndërtimin e kapaciteteve shkollore për inovacion, përmirësim dhe ndryshim (Hallinger & Leithöod, 1991).

Udhëheqja instruktive dhe transformuese, gjithashtu, promovohen edhe në standardet të cilat mbulojnë gjashtë dimensionet e një udhëheqësi profesional të shkollës dhe ndërlidhen me fushat e cilësisë së shkollës kundrejt të cilave vlerësohet performanca e udhëheqësit:

- 1 Udhëheqja dhe motivimi;
- 2 Mësimdhënia dhe mësimnxënia cilësore;
- 3 Planifikimi dhe menaxhimi;
- 4 Bashkëpunimi me komunitetin;
- 5 Shoqëria dhe legjislacioni; dhe
- 6 Etika profesionale.


Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave, (MASH, 2012)

> ROLI I DREJTORIT TË SHOLLËS

- Sigurimi i një mjedisi miqësor ndaj nxënësve, të sigurt, të këndshëm dhe të përshtatshëm për mësim
- Përfshirja e akterëve dhe partnerëve të arsimit në vendimet e shkollës
- Sigurimi i të mësuarit dhe zgjedhjes së diferencuar në kontekstin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtë-kurrikulare
- Sigurimi i qëndrueshmërisë në të gjithë shkollën ("qasja e tërë shkollës") në nxitjen e mësimdhënies me nxënësin në qendër të vëmendjes në ambientin e tyre
- Angazhimi në rrjetet e shkollave për të promovuar shkëmbimet dhe të mësuarit reciprok nga praktikatat efektive të mësimdhënies dhe mësimnxënies me nxënësin në qendër të vëmendjes
- Mbështetja e trajnimit dhe mentorimit të mësimdhënësve të bazuar në shkollë si një mjet për të përmirësuar aftësitë mësimore të personelit, duke kombinuar aspektet teorike dhe praktike në situatat e jetës reale në shkollë
- Bazuar në parimin e autonomisë së shkollës, vendosë në konsultim me katerët, për pjesën e Kurrikulës të bazuar në shkollë
- Në bashkëpunim me palët e interesuara, punon drejt zhvillimit të një koncepti (projekti) të qartë të shkollës që shpjegon vizionin dhe misionin e shkollës, si dhe mjetet që shkolla parashikon për të rritur cilësinë, barazinë dhe llogaridhënien e shërbimeve arsimore
- I kushton vëmendje të veçantë zbatimit të parimeve dhe praktikave të arsimit gjithëpërfshirës, duke marrë parasysh dhe adresuar diversitetin dhe nevojat e ndryshme të nxënësve, dhe duke luftuar kundër paragjyqimeve, trajtimeve të padrejta dhe dhunës
- I ndihmon shkollave që të bëhen organizata mësimore dhe "magnet" për komunitetin nëpërmjet krijimit të komuniteteve të praktikës; programeve të shkrim-lëximit dhe për mësimin e të rriturve; aktiviteteve teknologjike; programeve të tjera të orientuara drejt shërbimit të komunitetit

> ROLI I MËSIMDHËNËSIT TË SHKOLLËS

- Përdor një gamë të gjerë metodash të përshtatura për situatën dhe nevojat e nxënësve në kontekstin e pedagogjive interaktive
- Forcon lidhjet midis fushave të kurrikulës dhe lëndëve, dhe promovon mësim të integruar
- Është në gjendje të integrojë çështje të ndërlydhura, siç janë të drejtat e njeriut dhe edukimi për qytetari demokratike; edukimi për paqe; edukimi për zhvillim të qëndrueshëm; barazia gjinore; mirëkuptimi ndërkulturor; aftësitë për jetë; edukimi shëndetësor; edukimi ekonomik dhe sipërmarrës; edukimi për media; TIK-u dhe mësimi elektronik
- Është i interesuar dhe i aftë të marrë pjesë në zhvillimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore të personalizuara, si dhe krijimin e planeve fleksibile individuale të studimit në përputhje me parimin e autonomisë së shkollës
- Zotëron aftësinë për të identifikuar problemet/vështirësitë e mësimin dhe siguron mbështetje të përshtatshme
- Është i interesuar në përparimin dhe vlerësimin formativ me qëllim të ofrimit të udhëzimeve, këshillimit, motivimit dhe mbështetjes për nxënësit
- Komunikon mirë me nxënësit, prindërit dhe akterët e tjerë
- Lehtëson të nxënit për nxënësit dhe i angazhon ata në aktivitete kuptimplota
- Është i interesuar dhe i aftë të angazhohet në punën e ekipore dhe të marrë pjesë në komunitetet e praktikës



AKTIVITETI 6

Në grupe prej 4-5 veta, shikoni tabelën e mëposhtme dhe pajtohuni se cilat nga këto më sipër janë më të rëndësishme, cilat paraqesin sfida të konsiderueshme për ndryshim dhe cilat nuk paraqesin sfida. Shto sfida tjera që ndërlidhen me rolin e drejtorit dhe rolin e mësimit. Prezantoni punën tuaj para grupit të gjerë.

3.9. Të nxënës dhe mësimit elektronik (Mësimi elektronik/eLearning)⁸

Definicioni

Mësimi elektronik (eLearning) i referohet përdorimit internacional të rrjetit informatik dhe teknologjisë së komunikimit në mësimit dhe mësimit. Një numër i termave, gjithashtu i përdoren për të përshkruar këtë model të mësimit dhe mësimit. Ato përfshijnë: të nxënës online (online learning), të nxënës virtual (virtual learning), të nxënës distributiv/shpërndarës/ (distributed learning), të nxënës përmes rrjetit dhe ëbfaqeve (network and ebbased learning). Termi apo shkronja “e” – “elektronik” përfshinë të gjitha aktivitetet pedagogjike pamarëparasysht punën online ose offline individuale apo në grup, të sinkronizuar apo jo të sinkronizuar përmes rrjetit, kompjuterit apo shërbimeve tjera elektronike.

Mësimi elektronik (eLearning) pra i referohet përdorimit të teknologjisë së internetit apo ëireless, përdorimit të kompjuterit përmes internetit apo intranetit në marrjen apo shpërndarjen e informative përkatësisht përmbajtjeve.

Karakteristikat

Mësimi elektronik karakterizohet me:

- përdorimin e teknologjisë multimediale (tekst, fotografi, zëri, filmi, animimi ... përmes të cilave merret informacioni);
- komunikimi përmes internetit – në distancë

Komunikimi përmes internetit i sinkronizuar (chat), zhvillohet në vende të ndryshme psh. Prishtinë – Gjermani, informata e njejtë- në të njejtën kohë (drejtëpërdrejtë).

⁸ Naidu, E-learning – A Guidebook of Principles, Procedures and Practices. Commonwealth of Learning (PDF)

Komunikimi përmes internetit jo i sinkronizuar, zhvillohet jo në të njejtën kohë, psh. shtrohet një pyetje dhe përgjigja merret pas dy javëve, apo fillohet sot një diskutim dhe vazhdohet pas disa javëve.

Këto qasje mund të jenë individuale dhe në grupe:

Qasja individuale online – i referohet situatave kur studenti shfrytëzon burime të ndryshme për lëndën përmes internetit ose intanetit.

Qasja individuale offline i referohet situatave kur studenti përdorë burime tjera mediale si USB, CD ose DVD.

Përse zbatohet mësimi elektronik (e learning)?

- Shpërndarja gjeografike
- Koha e limituar
- Mundësi të kufizuara për udhëtim
- Papërshtatje e datave/orareve
- Konfliktet dhe postkonfliktet (pamundësia e mobilitetit të studentëve)
- Kufizimet për shkaqe të bindjeve kulturore, fetare etj.
- Izolimi i kushtëzuar i popullësisë si pasojë e pandemisë sic është rasti në 2020 COVID 19.

AKTIVITETI 7

- ➔ Diskutoni në grup: Si ka ndikuar virusi COVID-19 në shkollën tuaj?
- ➔ Si e keni përjetuar mbylljen e shkollave?
- ➔ Si jeni gjendur me zbatimin e mësimin online?
- ➔ Çfarë problemesh keni ndeshur?
- ➔ Çfarë konsideroni si pika të dobta dhe pika të mira në këtë proces?
- ➔ Çfarë duhet bërë dhe çfarë mund të bëni nëse për çfarëdo situatë tjetër imponohet mësimi online?
- ➔ Ku duhet përqëndruar më shumë?

3.10. Të kushtëzuarit për mësim 'online' si pasojë e situatave të jashtëzakonshme

Situatat e jashtëzakonshme, sikur pandemia globale, është sigurisht jo vetëm një emergjencë serioze e shëndetit publik, por edhe një emergjencë politike, ekonomike dhe sociale. Hulumtimet në të ardhmen do të përfshijnë sjellje në lidhje me këto situata, nga keqinformimi dhe masat ekonomike deri te politikat e distancimit shoqëror, karantinimit dhe izolimit; përdorimin dhe keqpërdorimin e të dhënave, statistikave dhe vizualizimeve në shkallë të gjerë; forma të reja të punës, kulturës dhe jetës personale të ndërmjetësuar dixhitalisht; sistemet e mbikëqyrjes për 'gjurmimin e kontaktit'; përdorimi i modelimit parashikues epidemiologjik; zhvillimi i teknikave për një kuptim më të mirë publik të shkencës; dhe përdorimi politik i ekonomisë së sjelljes si një pedagogji publike e menaxhimit të popullsisë.

Në vitin e fundit, përhapja e corona virusit ndikoi negativisht në aktivitetet arsimore në të gjithë botën. Pandemia e corona virusit preku sistemet arsimore në të gjithë botën, duke çuar në mbyllje të shkollave.

Në kohën e një bllokimi global, me mbylljen e shkollave dhe universiteteve, nevoja për të kaluar shpejt nga mësimdhënia ballë për ballë, në klasa tgradicionale në mësimdhënien 'online' sjell sfida për të gjithë mësimdhënësit e të gjitha niveleve të arsimit.

Situatat e jashtëzakonshme, sikur Pandemia COVID- 19, ndryshojnë jetën tonë të përditshme në shumë mënyra dhe, në veçanti, sektorin e arsimit. Implikimet dhe pasojat në arsim janë ende për t'u njohur. Sidoqoftë, këto situata e bëjnë të dukshme dhe madje i përkeqësojnë pabarazitë në qasjen në arsim, por gjithashtu përfshin mundësi për të riformuar arsimimin e mësimdhënësve (Flores, 2020).

3.11. Modeli online -Mësimi nga distanca

AKTIVITETI 8

- ➔ Lexoni individualisht tekstin në vijim për mësimin online. Pas leximit, diskutoni në dyshe për rolin e mësimdhënësit në mësimin online?
- ➔ Paraqitni disa ide se çfarë duhet dhe mund të bëni për të përkrahur mësimdhënësit për mësimin online?

Mësimi online është vetëm një lloj i mësimin në distancë, është "ombrellë" për çdo mësim që zhvillohet në distancë dhe jo në një klasë tradicionale. Kërkesa minimale për nxënësit për të marrë pjesë në mësimin online është qasja në kompjuter, internet dhe motivimi për të patur sukses në një klasë jo-tradicionale.

Modeli online thekson një mjedis mësimor ndërveprues, i krijuar për të stimuluar dialogun midis mësimdhënësit dhe nxënësve dhe midis vetë nxënësve. Procesi online kërkon që mësimdhënësi dhe

nxënësit të marrin role aktive. Mësimdhënësi shpesh do të veprojë si një ndihmës, duke organizuar aktivitete që angazhojnë nxënësit drejtpërdrejt në vend që të mbështeten shumë në leksione dhe mësimë përmendësh.

Mësimdhënësi

Një mësimdhënësi përgjatë mësimin online, duhet të jetë në gjendje të pranojë vlerën e të mësuarit të lehtësuar si të barabartë me modelin tradicional. Nëse një mësimdhënësi mendon se mënyra e vetme që mund të zhvillohet të mësuarit e vërtetë është përmes mjeteve tradicionale të arsimit në një klasë, ai nuk është i përshtatshëm për paradigmen e të nxënësit dhe mësimdhënies online. Klasa në mësimin online (klasa virtuale), kërkon strategji të reja të mësimdhënies. Personi që drejton një orë të suksesshme në mësimin online duhet të jetë i tharë i të nxënësit lehtësues dhe të ketë besim në sistem në mënyrë që ta bëjë atë të funksionojë.

Një mësimdhënësi në mësim online duhet të jetë në gjendje të kompensojë mungesën e pranisë fizike në klasën virtuale duke krijuar një mjedis mbështetës ku të gjithë nxënësit ndihen rehat duke marrë pjesë dhe veçanërisht kur nxënësit e dinë që mësimdhënësi i tyre është i arritshëm. Mosarritja për ta bërë këtë mund ta tjetërsojë klasën si nga njëri-tjetri ashtu edhe nga mësimdhënësi dhe do të krijonte një mjedis shumë të dobët të të nxënësit. Studentët në mësimin online janë po aq të zënë ose më të zënë, se sa në klasa tradicionale. Ai duhet të jetë i gatshëm t'u kushtojë vëmendje individuale nxënësve dhe t'i plotësojë nevojat e tyre. Të qenit i ndjeshëm, i hapur dhe fleksibël është i detyrueshëm për sukses në modelin online (Stern, J. Introduction to Online Teaching and Learning, PDF)

Mësimdhënësit duhet të ndërtojnë mundësi të tilla përmes nxitjes së hapësirave kritike të të nxënësit, ku nxënësit inkurajohen të rrisin kapacitetet e tyre të analizës, imagjinatës, sintezës kritike, shprehjes krijuese, vetëdijësit dhe qëllimit në veprim. Vetëm lëndë të dizajnuara mirë dhe të ofruara në mënyrë efektive në klasa virtuale mund të mbijetojnë për të përmbushur mundësinë e realizimit të kurrikulës dhe të rezultateve të përcaktuara nga mësimdhënësi.

Në mësimin online dhe për punë me klasa virtuale mësimdhënësit duhet të jenë:

- të përgatitur mirë për të përdorur informacionin, komunikimin dhe mjetet moderne të të nxënësit
- të motivuar që të punojnë mirë pa mbikëqyrje të vazhdueshme
- në mbështetje të vazhdueshme të nxënësve dhe fleksibël, duke ruajtur standarde të larta
- në gjendje të promovojnë dialogun në mësimin 'online' për të thelluar përvojën e të mësuarit
- të nxënësit dhe ndërtojnë grupe në mënyrë virtuale dhe të lehtësojnë të nxënësit në bashkëpunim
- në gjendje të bashkëpunojnë me nxënësit dhe stafin, sistemet mbështetëse të nxënësve për pjesëmarrjen e mëtejshme të nxënësve dhe suksesin në kursin 'online'
- të specifikojnë rezultatet e të nxënësit dhe hartojnë aktivitete dhe vlerësime autentike për të matur zotërimin e rezultateve të deklaruara
- në gjendje të përdorin teknologjinë të përshtatshme për të përmbushur nevojat individuale të nxënësve
- të posedojnë një sens humori dhe janë në gjendje të "projektojnë" personalitetin e tyre përmes zhvillimit të një "zëri në internet"

- të shfaqin zotërim të mjedisit 'online' dhe të menaxhojnë përmbajtjet që do të përdoren
- efektiv në komunikimet me shkrim (National Education Association, Guide to teaching Courses)

Disa standarde për lëndët

Lëndët (kurset) duhet:

- të drejtohen përkatësisht lehtësohen nga mësimdhënësit. Mësimdhënësit mund të lehtësojnë të nxënëit e nxënësve duke punuar me nxënës duke mbajtur përqendrimin në detyrë dhe për të organizuar kohën e tyre në mënyrë të përshtatshme për të siguruar sukses në një mjedis virtual.
- të jenë me nxënësin në qendër. Duhet hartuar veprimtari sfiduese duke ofruar udhëzime efektive dhe reagime cilësore të nxënësve.
- të ketë natyrë bashkëpunuese. Mësimdhënia duhet të përmbajnë aktivitete të grupeve të vogla dhe projekte ekipore ku nxënësit duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që të nxisin një ndërveprim 'online' të nxënësve.
- të maksimizojnë detyrat e lëndëve/ kurseve dhe fleksibilitetin e pjesëmarrjes dhe të ofrojnë një kornizë për përparimin e nxënësve. Mësimet duhet të jenë të planifikuara - domethënë, nxënësit duhet të kryejnë aktivitetet e vendosura brenda një afati të caktuar kohor.
- të nxisin aftësitë e informacionit, komunikimit dhe teknologjisë të nevojshme për sukses në shekullin 21 dhe TIK (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit), që nxënësit të jenë të aftë të përdorin aftësitë e të menduarit krijues - krijimtarinë, zgjidhjen e problemeve dhe mendimin kritik.

4. Performanca e nxënësve

Standardi i dytë i praktikës profesionale për drejtorët e shkollave- Mësimdhënia dhe Mësimnxënia Cilësore- kërkon që drejtori i shkollës të njihet dhe të kuptojë matjen dhe vlerësimin e nxënësve ; Vlerësimin për të Nxënit (Vlerësimin Formativ) dhe Vlerësimin e të Nxënit (Vlerësimin Sumativ) dhe për të siguruar që drejtorët e shkollave janë përgjegjës për “të siguruar që praktikatat e vlerësimit me bazë në shkollë janë të përshtatshme dhe të harmonizuara me Kurrikulën e Re të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve.

4.1. Vlerësimi i të Nxënit dhe Vlerësimi për të Nxënit (Vlerësimi Formativ dhe Vlerësimi Sumativ)⁹

Sa i përket vlerësimit të nxënësve, janë dy përgjegjësi të rëndësishme për drejtorët e shkollave. E para është përgjegjësia e tyre e re që ka të bëjë me zbatimin e kurrikulës së re, duke përfshirë qasjet e reja të vlerësimit (Formativ dhe Sumativ). E dyta është përgjegjësia e tyre për të mbikëqyrur praktikatat e mësimdhënësve kur bëhet fjalë për vlerësimin e të nxënit të nxënësve. Kjo do të thotë që drejtorët duhet të kenë njohuri themelore të formave të reja të vlerësimit dhe zbatimin e duhur të UA¹⁰ për vlerësim, Kodit të Etikës për Vlerësimin e Nxënësve si dhe Standardeve të Vlerësimit me bazë në Shkollë. Kjo njohuri nevojitet për të inkurajuar mësimdhënësit që të praktikojnë vazhdimisht dhe në mënyrë të duhur vlerësimin për të Nxënit (Vlerësimin Formativ), pasi që është një mjet më i fuqishëm për mësimin dhe përmirësimin e të nxënit të nxënësve sesa vlerësimi përmbledhës (notimi). Drejtorët e shkollave duhet të sigurojnë që mësimdhënësit të kryejnë vlerësimin përmbledhës në mënyrë korrekte gjithashtu, dhe të jenë në përputhje me politikat e reja të vlerësimit.

KKK-ja promovon një qasje të re të sistemit të vlerësimit të nxënësve, ku vlerësimi i nxënësve pritet të bazohet në rezultatet mësimore të fushave të kurrikulës dhe rezultatet kryesore të ndërlidhura me kompetencat kyçe. Ky sistem i vlerësimit kërkon që drejtori i shkollës të konsultohet vazhdimisht me mësimdhënësit mbi praktikatat e reja të vlerësimit si një mjet kryesor për të mbështetur nxënësit në arritjen e kompetencave kyçe të KKK-së.

Për t'iu dhënë drejtorëve të shkollave njohuritë themelore të nevojshme, mëposhtë do të shqyrtohen:

- Përkufizimet e vlerësimit, parimet e vlerësimit dhe objektivat
- Llojet e vlerësimit

Fokusi është në praktikatat e pritura të vlerësimit të mësimdhënësve në lidhje me mësimin e nxënësve.

¹⁰ Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve, MASH 08/2016

4.1.1 Përkufizimet e vlerësimit, parimet e vlerësimit dhe objektivat

Dy llojet kryesore të vlerësimit të bazuar në klasë janë:

- **VLERËSIMI PËR TË NXËNIT - VLERËSIMI FORMATIV:** monitoron progresin e nxënësve në procesin e të nxënësve dhe siguron informata kthyesë për të lehtësuar/përmirësuar të nxënësve dhe për të përmirësuar mësimdhënien.
- **VLERËSIMI I TË NXËNIT - VLERËSIMI PËRMBLEDHËS:** përcakton arritjet në përfundim të një detyre të caktuar, kapitulli, gjysmëvjetori ose viti shkollor për t'i notuar nxënësit ose për të certifikuar nxënësit për të mësuarit gjatë një periudhe të caktuar. Gjithashtu, përdoret për të gjykuar efikasitetin e mësimdhënies ose kurrikulës.

Vlerësimi i nxënësve është pjesë përbërëse e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përmes së cilës ne kuptojmë se deri në çfarë mase nxënësit kanë fituar njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në njërin nga kompetencat e kurrikulës, ose në një fushë të kurrikulës, ose në lëndën apo në rezultatet e të nxënësve. Korniza e Kurrikulës së Kosovës përkufizon *vlerësimin si një proces i mbledhjes së informatave dhe marrjes së vendimeve lidhur me arritjet ose performancën e nxënësve*. Kjo do të thotë se vlerësimi nuk është vetëm një gjykim i vlefshëm për matjen sasiorë dhe cilësore të arritjeve të nxënësve pasi që kur nxënësit e praktikojnë vetë-vlerësimin si teknikë të Vlerësimit Formativ si një sjellje të vazhdueshme atëherë kjo sjellje bëhet si një bazë për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Përkufizimi i vlerësimit:

Vlerësimi është një proces i hulumtimit dhe interpretimit të provave nga nxënësit dhe mësimdhënësit e tyre për të marrë vendime se ku janë nxënësit, ku duhet të arrijnë dhe si t'i arrijnë rezultatet më së miri. (Grupi i Reformës së Vlerësimit, 2002)

4.2 Parimet dhe objektivat për procesin e vlerësimit

4.2.1 Parimet e vlerësimit

Udhëzimi i MASH-it - Kodi i Etikës për Vlerësimin e Nxënësve - përcakton parimet e vlerësimit për sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë. Bazuar në këtë Udhëzim, ekzistojnë gjashtë parime themelore të vlerësimit që duhet të respektohen nga institucionet arsimore:

- 1 Respektimi i ligjit dhe parimeve demografike
- 2 Respektimi i individëve, të drejtave të tyre dhe dallimeve individuale
- 3 Drejtësia dhe korrektësia për të gjithë në zbatimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin e nxënësve
- 4 Standardet më të larta të integritetit në të gjitha aspektet e procesit të vlerësimit
- 5 Saktësia në mbledhjen e informatave mbi arritjet e nxënësve dhe raportimin
- 6 Promovimi i standardeve më të larta të arritjes dhe të mësimit gjatë gjithë jetës.

4.2.2 Objektivat e vlerësimit

Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe UA 08/16, MASH, i ka përcaktuar objektivat për vlerësimin e nxënësve me bazë në klasë dhe në vlerësimin e jashtëm.

Objektivat e vlerësimit për vlerësimin e nxënësve me bazë në klasë përfshijnë si në vijim:

- ✓ Planifikimi i punës së mëtejshme me nxënësit
- ✓ Vlerësimi i arritjeve të nxënësve, dhe
- ✓ Identifikimi i telasheve, talenteve dhe dhuntive të nxënësve.

Objektivat e vlerësimit për vlerësimin e nxënësve me bazë në klasë përfshijnë si në vijim:

- ✓ Verifikimi i cilësisë së vlerësimit të bazuar në klasë, të bazuar në shkollë ose të bazuar në komuna
- ✓ Vlerësimi i standardizuar në nivelin shtetëror
- ✓ Hulumtime
- ✓ Përdorimi i rezultateve për regjistrim në nivele të tjera të arsimit, ndryshimi i politikave arsimore
- ✓ Krahasimi me vendet e tjera.

LLOJET E VLERËSIMIT

4.3 Llojet e vlerësimit sipas Kurrikulën e Re të Kosovës

Sipas Udhëzimit Administrativ (UA 08/2016, MASH) i cili bazohet në Kurrikulën e Re të Kosovës 2016, vlerësimi i nxënësve përfshinë tri lloje të vlerësimit:

- ✓ **VLERËSIMI I BAZUAR NË SHKOLLË I CILI** përbëhet nga vlerësimi i vazhdueshëm (Formativ dhe Përmbledhës) dhe vlerësimi përfundimtar (Përmbledhës në fund të gjysmëvjetorit).
- ✓ **VLERËSIMI I SHKALLËS I CILI** realizohet në fund të secilës shkallë kurrikulare.
- ✓ **VLERËSIMI I JASHTËM I CILI** bëhet në fund të klasës 5, 9 dhe 12. Zbatimi dhe ndikimi i mësimdhënies dhe vlerësimit në performancën e nxënësve do të monitorohet nga Aktivat Profesional dhe Koordinatorët e Cilësisë, dhe gjithashtu duhet të jetë pjesë e Planit Zhvillimor të Shkollës.

4.3.1 Vlerësimi me bazë në shkollë

Vlerësimi me bazë në shkollë realizohet nga mësimdhënësit dhe qëllimi kryesor i tij është përmirësimi i mësimnxënies nga ana e nxënësve, planifikimi i mësimnxënies në të ardhmen dhe identifikimi i nxënësve që kanë telashe në mësim dhe/ose i nxënësve të talentuar.

Fokusi kryesor i vlerësimit të bazuar në shkollë është mbështetja e të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave, ku kjo arrihet duke zbatuar vlerësimin formativ në baza ditore si dhe në periudha të caktuara kohore vlerësimin përmbledhës.

Vlerësimi me bazë në shkollë përbëhet nga: Vlerësimi i Vazhdueshëm, Vlerësimi Përfundimtar dhe Vlerësimi i shkallës

Vlerësimi me bazë në shkollë	Përgjegjës		Klasa	Qëllimi i vlerësimit	Dokumentimi dhe Raportimi		
<p>Vlerësimi i vazhdueshëm</p> <p>Realizohet gjatë tërë vitit shkollor i ndarë në tre afate:</p> <p>1. shtator – dhjetor</p> <p>2. janar – mars</p> <p>3. prill – qershor</p>	Vlerësimi formues		Mësimdhënësi	0 – 12	Gjatë procesit mësimor me qëllim të mbështetjes së nxënësve në mësimnxënie duke siguruar informata kthyesë dhe raportime me komente	Takimi individual me nxënësit ose prindërit për t'i informuar ata për përparimin e nxënësit. Ose mund të jetë një raport i shkruar me komente që informon nxënësin për arritjen e rezultateve të të nxënëtit dhe i orienton ata se çfarë duhet të bëjnë më pas në mënyrë që të përmirësohet mësimi.	
	Vlerësimi përmbledhës.	SA1	Mësimdhënësi	0 – 12	Raportimi i progresit përmes notimit në periudha të caktuara në ditarin e mësimdhënësit	Nota e një gjysmëvjetori formohet nga mesatarja e të gjitha notave të atij gjysmëvjetori në lëndën specifike dhe transferohet në ditarin e klasës.	Nota përfundimtare e një gjysmëvjetori bëhet duke llogaritur dhe raportohet në ditarin e klasës dhe në raport në fund të gjysmëvjetorit.
		SA2	Mësimdhënësi dhe aktivtati profesionale	6 – 12	Raportimi i progresit me një provim përmbledhës në fund të gjysmëvjetorit	Vetëm për klasat 0-5 nota nga vlerësimi përmbledhës (FA) raportohet si notë përfundimtare për një gjysmëvjetor	
Vlerësimi përfundimtar	Mësimdhënësi		Klasa	0 – 2	Komente dhe informata kthyesë në regjistrin personal të mësimdhënësit dhe në ditarin e klasës, si dhe në indeksin e nxënësit	Përshkrimi i të arriturve të rezultateve mësimore raportohen në fund të vitit shkollor.	
	Këshilli			3 – 12	Notat numerike në ditarin e klasës/vlerësimet numerike dhe përshkruese (kl.3-5)	Notat dhe vlerësimi përshkrues mbi arritjen e rezultateve mësimore raportohen në indeksin e nxënësit.	
Vlerësimi i fazës	MASH/Komuna/shkolla/mësimdhënësit		2, 5, 7, 11	Notat (A, B, C, D) qëllimi i këtij vlerësimi është t'i informojë nxënësit dhe shkollën për arritjen e secilit nxënës individual, në mënyrë që të përgatitet një plan individual për mbështetjen e nxënësit në vitin e ardhshëm shkollor.	Raportet e veçanta që do t'i shërbejnë nxënësve për të përmirësuar mësimin e tyre dhe për mësimdhënësit/shkollat që të reflektojnë në mësimdhënien e tyre.		

Figura 4.1 . Marrë nga Udhëzuesi i Mësimdhënësve për Vlerësim bazuar në Kurrikulën e re (MASH, 2016)

AKTIVITETI 10

- Diskutoni në grup: Si ka rrjedhur procesi i vlerësimit të brendshëm (Vlerësimi i vazhdueshëm, Vlerësimi përfundimtar dhe Vlerësimi i shkallës) në shkollën tuaj?
- Listoni problemet dhe sfidat në këtë process?
- Paraqitni ide si mund të përmirësohet ky process?

4.3.2. Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i jashtëm është një vlerësim i standardizuar që matë nivelin e arritjes së rezultateve të nxëniet dhe zhvillimin e kompetencave për nivelin e arsimit I, II dhe III. Provimet kombëtare të standardizuara organizohen nga MASH-i dhe kryhen në klasat 5, 9 dhe 12 për qëllime të ndryshme.¹¹

Përveç provimeve kombëtare/vlerësimeve të jashtme, Kosova për herë të parë në vitin 2015 mori pjesë në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve¹² (PISA) të organizuar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). PISA është një studim ndërkombëtar i arsimit që vlerëson kompetencat e nxënësve 15-vjeçarë në matematikë, lexim dhe shkencë. Qëllimi i këtij studimi i cili realizohet çdo tre vjet, është mbledhja e të dhënave të besueshme për njohuritë dhe aftësitë e nxënësve, dhe për të vlerësuar shkallën në të cilën nxënësit janë të aftë ose të përgatitur për të aplikuar njohuritë e tyre në situatat e jetës reale, dhe janë të gatshëm të bëhen pjesë e integruar e një shoqërie globale.

Janë më shumë se 70 vende që marrin pjesë në PISA. Pjesëmarrja e Kosovës në PISA 2015 bëri të mundur për herë të parë për të krahasuar sistemin arsimor të Kosovës me vendet e tjera. Megjithëse rezultatet e PISA 2015 janë dekurajuese pasi që ato paraqesin një sistem të dobët arsimor, respektivisht performancë të ulët të nxënësve 15 vjeçarë - të cilët mbesin prapa moshatarëve të tyre në vendet e OBEZh-it me afro tre vjet arsimim, në të njëjtën kohë ajo shërben si bazë për një reformë të politikës arsimore. PSAK-u 2017-2021 i cili tashmë është hartuar me nevoja dhe objektiva specifike, do të duhej të ishte prioritet i qeverisë, duke caktuar një buxhet të mjaftueshëm i cili do t'i shërbente zbatimit të suksesshëm nga ana e MASH-it, komunave dhe shkollave me ndihmën e komuniteteve dhe akterëve të tjerë. Megjithëse theksi ende mbetet në vlerësimin përmbledhës, që është e rëndësishme që të zbatohet në mënyrë të drejtë dhe korrekte dhe të harmonizohet me politikat e reja të vlerësimit, megjithatë, ajo që nxit mësimnxënien për shumicën e nxënësve është vlerësimi formativ apo ndryshe edhe si quhet vlerësimi për të nxënësit . Duke qenë se shumica e mësimdhënësve të shkollave fillore janë trajnuar tashmë në vlerësimin formativ¹³, është përgjegjësi e drejtorit të shkollës që të sigurojë që kjo formë e vlerësimit të zbatohet rregullisht nga të gjithë mësimdhënësit.

11 Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve, MASH 08/2016

12 Raporti për të arriturat e nxënësve të Kosovës në PISA 2015 (MASH, 2016)

13 Udhëzuesi për Vlerësimin Formues, BEP/MEST 2015

AKTIVITETI 11

Të gjithë pajtohemi se nuk jemi të kënaqur aspak me rezultatet e nxënësve tanë në testin PISA.

→ Paraqitni ide se si mund të ndikojmë për të përmirësuar këtë proces?

AKTIVITETI 12

Analizoni profilin e shkollës. Ilustroni me shembuj.

→ Cila nga fushat e cilësisë së shkollës mund të përmirësohet pa burime financiare shtesë duke arritur kështu një cilësi më të lartë të arsimit?

SKENARI I PARË

Mësimdhënësi i historisë shpesh u jep për detyrë nxënësve ese dhe raporte. Më e rëndësishme se rezultati në ese për mësimdhënësin është që nxënësit të lexojnë komentet e shumta që mësimdhënësi i ka vendosur në detyrat e tyre si informata kthyese. Këto informata kthyese përfshijnë korrigjime në gramatikë dhe stil, por më e rëndësishmja është se i sfidon konkluzionet e tyre kur esetë nuk kanë dëshmi për të mbështetur konkludimet e tyre. Ai gjithashtu i parashtron pyetje nxënësve që të mendojnë. Çfarë mund të bëjë ky mësimdhënësi ndryshe për t'i bërë nxënësit që t'i përgjigjen informatave kthyese dhe kështu duke përmirësuar cilësinë e eseve dhe raporteve të tyre.

SKENARI I DYTË

Mësimdhënësi i shkencës ka filluar përdorimin e eksperimenteve si një mjet për t'i bërë nxënësit të mësojnë shkencën. Detyrat e eksperimentit për nxënësit janë të planifikuara mirë; rezultatet e synuara të mësimin janë të qarta dhe shumica e nxënësve i kuptojnë ato. Megjithatë, mësimdhënësi sheh rreth një të tretën e klasës me të vërtetë duke pasur vështirësi në ndjekjen e procesit me eksperimente me rezultatin ku përgjigjet e tyre janë shumë të pasakta. Mësimdhënësi është i vetëdijshëm në notimin e detyrave dhe qartë vë në dukje gabimet e nxënësve me ngjyrë të kuqe. Përkundër kësaj, nxënësit nuk po përmirësohen. Si mund ta vlerësojë ai punën e nxënësve ndryshe në mënyrë që nxënësit ta kuptojnë mësimin? Çfarë mund të bëjë mësimdhënësi që t'i bëjë nxënësit të kuptojnë procesin shkencor në eksperimente?

Lexoni dokumentin e bashkangjitur mbi Vlerësimin për Nxënie . (Shtojca A). Më pas, rishikoni përgjigjet tuaja për Aktivitetin 4.1. Si dallojnë përgjigjet tuaja pas leximit të materialit?

GRUPI DETYRAT DHE PYETJET PËR DISKUTIM

1

Si do të reagonit/mbështetnit mësimdhënësit tuaj nëse ai/ajo do të shprehte mendimin se vlerësimi formativ është i mirë në parim, por zbatimi i tij në praktikë kërkon shumë kohë dhe nuk mund të zbatohet?

Hartoni një listë udhëzimesh se si do t'i mbështetnit mësimdhënësit në planifikimin e vlerësimit formativ dhe vlerësimin përmbljedhës.

2

Hartoni një listë udhëzimesh për të diskutuar me mësimdhënësit në shkollën tuaj se si aktivitetet e mëposhtme mund t'i ndihmojnë ata për të vlerësuar përparimin e nxënësve.

- Vlerësimi i nxënësve
- Vetëvlerësimi i nxënësve apo vlerësimi i njëri-tjetrit
- Rishikimi i shembujve të punës së nxënësve
- Krijimi i portfolios për vlerësimin e nxënësve
- Organizimi i testit

3

Hartoni një listë të ideve/praktikave për mësimdhënësit se si mund të integrojnë vlerësimin formativ në praktikat e tyre të mësimdhënies.

Hartoni një koncept dokument mbi mënyrën se si drejtori i shkollës mund të sigurojë që praktikat e vlerësimit të bazuara në shkollë janë të përshtatshme dhe të balancuara.

4

Përgatitni një plan orientues për zbatimin e vlerësimit të bazuar në shkollë (kur duhet të zhvillohet, kush e bën atë, si mund të mbështeten dhe monitorohen mësimdhënësit, dhe si/kujt do t'i raportoni)?

(Grupi përdor udhëzuesin për mësimdhënësit: Vlerësimi i bazuar me Kurrikulën e bazuar në kompetenca, MASH 2016)

5

Si do të reagonit/mbështetnit mësimdhënësin nëse ai/ajo shpreh mendimin se standardet e vlerësimit të hartuara nga MASH-i janë të mira në parim, por zbatimi i tyre në praktikë është i vështirë të arrihet?

Hartoni një listë të ideve se si do t'i bënit mësimdhënësit të vetëdijshëm dhe të zbatojnë standardet e vlerësimit në politikë (MASH, 2011) në punën e tyre me nxënësit.

(Grupi përdor dokumentin: Standardet e Vlerësimit me Bazë në Shkollë, MASH 2011)

5. Kultura dhe mjedisi shkollor

Siguria e fëmijëve në shkollë është një parakusht themelor për realizimin e mësimin efektiv dhe të qëndrueshëm. Siç cekët edhe në kornizën për sigurimin e cilësisë, autoritetet e arsimit, komuniteti, menaxhmenti i shkollës dhe mësimdhënësit duhet të sigurojnë që mjedisi dhe kultura e shkollës bazohen në standardet e përcaktuara në Udhëzimet Administrative përkatëse, dhe nuk guxojnë të përmbajnë rreziqe të mundshme fizike, emocionale dhe sociale. Qëllimi kryesor i kulturës dhe mjedisit është të sigurohen parakushte të përshtatshme *për zhvillimin e të gjitha kompetencave të nxënësve në përputhje me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës*. Përveç aktiviteteve të përfshira në Kurrikulë, edhe shkollat organizojnë aktivitete jashtëshkollore të cilat lidhen me rezultatet e mësimin, por që mund të zhvillohen jashtë shkollave.

5.1 Aktivitetet jashtëkurrikulare

Për ta plotësuar kurrikulën formale dhe për t'a bërë shkollën më atraktive, aktivitetet jashtëkurrikulare janë mënyra më e mirë për t'i mbajtur fëmijët dhe prindërit afër shkollës. Megjithëse aktivitetet jashtëshkollore nuk janë formale, ato patjetër duhet të harmonizohen me filozofinë e Kurrikulës së Re dhe me UA 18/2014 për aktivitetet jashtëshkollore.

Këto aktivitete shkojnë nga mbështetja individuale për nxënësit deri tek sporti, muzika, klube, puna vullnetare, udhëtime shkollore, ceremoni të diplomimit etj.

Bazuar në UA 18/2014¹⁴, të gjitha aktivitetet jashtëshkollore, duhet të miratohen nga drejtori i shkollës pas një konsultimi me mësimdhënësit dhe prindërit e nxënësve, dhe duhet të jenë në përputhje me ligjin siç ceket në UA 18/2014.

Disa nga aktivitetet jashtëshkollore të sugjeruara nga ky Udhëzim Administrativ janë:

- 1 Klube për lëndë dhe interesa të ndryshme të nxënësve (klubi i teknologjisë, klubi i gjelbër, këshilli i nxënësve, klubi i teatrit, klubi i vallëzimit, aftësitë për jetë etj.);
- 2 Aktivitetet që promovojnë mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit;
- 3 Ceremonitë e diplomimit (në fund të klasës së 5, 9 dhe 12)
- 4 Udhëtime, vizita të shkollës në institucione publike dhe private, ekskursione;
- 5 Aktivitete vjetore, të tilla si: shëtitje dhe piknik;
- 6 Vullnetarizmi për komunitetin - për të ndihmuar njerëzit e moshuar, njerëzit në nevojë dhe grupet e marginalizuara;

¹⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Udhëzimi Administrativ 22/2014 për Aktivitetet Jashtëkurrikulare

- 7 Mbështetje për nxënësit me performancë të dobët nga nxënësit më të vjetër;
- 8 Klubet për nxënësit e talentuar
- 9 Metodat e mësimdhënies pjesëmarrëse, me fëmijët në qendër të vëmendjes dhe të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore;
- 10 Integrimi i fëmijëve në mësimet plotësuese të organizuara nga të tjerët (OJQ-të, agjencitë arsimore);
- 11 Zhvillimi i mjediseve shkollore dhe materialeve mësimore për të plotësuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Për shumë nxënës, aktivitetet jashtëkurrikulare paraqesin një mundësi për të praktikuar shkathtësitë sociale dhe për të provuar aktivitete, të cilat edhe mund të nxisin interesim për ndonjë karrierë. Për një nxënës, i cili nuk qëndron mirë akademikisht, mundësia për të shkëlqyer në arte apo sporte mund të bëjë një ndryshim të madh në **vetëvlerësimin** e tij apo saj.

Për më tepër ne e dijmë nga studimet e ndryshme ndërkombëtare që aktivitetet jashtëkurrikulare janë të nevojshme për **vetëbesim**, i cili është i rëndësishëm për mësimnxënie më të mirë dhe sukses në provime. Përveç kësaj, ne mund të mësojmë më mirë nëse dy anët e trurit tonë janë aktive. Për shembull ekziston një korelacion ndërmjet muzikës dhe matematikës, dhe ndërmjet kreativitetit dhe gjetjes së zgjidhjeve për problemet. Një shembull tjetër na paraqet fushën e ndërmarrësisë: në ditët e sotme menaxherët nuk duhet të kenë vetëm njohuri për menaxhimin të një kompanie, por gjithashtu edhe shkathtësi emocionale, personale dhe sociale për udhëheqje. Fatkeqësisht, shumë shkolla nuk i krijojnë mundësitë për nxënës për të zhvilluar dhe përkrahur shkathtësitë e tilla të rëndësishme. Në këtë kohë e sidomos në të ardhmën, nuk do të mjaftoj vetëm dija që të jemi të sukseshëm profesionalisht.

Me qëllim të përkrahjes të aktiviteteve të tilla jashtëkurrikulare dhe përkrahjes të çdo nxënësi, është e dobishme të ketë shkolla me orar të plotë, ku nxënësit kanë kohë për mësim dhe zhvillim të aftësive të tyre dhe mësimdhënësit kanë kohë të njohin plotësisht personin dhe karakterin e çdo nxënësi. Duke qenë se Këshillat e Nxënësve janë të detyrueshme në shkollat e Kosovës, shumica e aktiviteteve jashtëkurrikulare mund të iniciohen nga këshilli i nxënësve dhe pastaj të diskutohen me Këshillin Drejtues të shkollës dhe Këshillin e Prindërve, dhe në fund të miratohen nga drejtori i shkollës.

5.2 Pjesëmarrja e komunitetit

Bashkëpunimi në partneritet nënkupton takimin e drejtpërdrejtë sy më sy me prindërit. Kjo nënkupton inkurajimin e tyre që të jenë ekspertë mbi zhvillimin e fëmijëve të tyre dhe të përdorin forcat e tyre për t'a bërë këtë. Një bashkëpunim i tillë me prindërit, i bazuar në partneritet dhe në marrëveshjet, të cilat obligojnë të dyja anët (palët) mund të ndryshojnë qëndrimin e prindërve ndaj arsimimit dhe shkollimit.

Të gjithë prindërit/kujdestarët dhe pjesëtarët tjerë të komunitetit duhet inkurajuar të luajnë një rol aktiv në arsimimin e fëmijëve të tyre apo anëtarëve të familjes. Në këtë mënyrë, shkollat gjithashtu mund të përfitojnë, duke pasur burime shtesë, por gjithashtu një kuptim më të mirë të së kaluarës së nxënësve të tyre. Komuniteti po ashtu mund të ketë një rol të rëndësishëm në çdo planifikim ose aktivitet, që shkollat mund t'a bëjnë, meqë pjesëtarët e komunitetit mund të përfshihen në aktivitetet e ndryshme të shkollës siç janë: ngjarjet për ngritje të vetëdijes, gjetja e fondeve, etj.

Është qenësore që të lejohen prindërit të kontribuojnë dhe të përdorin të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe kapacitetet e tyre për të përkrahur zhvillimin e fëmijëve të tyre. Ata janë ekspertë dhe partnerë në arsim. Për më tepër, ligji kërkon që çdo shkollë të themelojë Këshillin e Prindërve dhe pritet që të funksionojë si duhet.

Për të krijuar bashkëpunim të mirë me prindërit është e nevojshme:

- Të krijohet një marrëdhënie e hapur besimi
- T'u qasemi prindërve në partneritet
- Të përfshihen prindërit si partnerë
- Të aktivizohen burimet e prindërve
- Të paraqitet një kulturë shkollore që ndërtohet në komunitet dhe partneritet në lidhje me prindërit

Por atëherë njeriu mund të pyes, se cilat do të ishin përparësitë e ekzistimit të pjesëmarrjes së komunitetit në shkolla?

Bazuar në një raport të Qendrës për Arsim Ndërkombëtar të Universitetit të Sussex-it (korrik 2007),¹⁵ nga literatura e shqyrtuar në favor të pjesëmarrjes së komunitetit doli se:

Argumentet në favor të pjesëmarrjes së komunitetit janë si në vijim:

- ✓ Mobilizimi i burimeve shtesë për shkollim (përmes ndarjes së shpenzimeve)
- ✓ Pronësi e shtuar (p.sh. përmes alokimit të burimeve dhe vendimmarrjes)
- ✓ Përgjegjësi e shtuar e shkollave
- ✓ Efikasitet i shtuar në shkolla
- ✓ Përgjegjësi e shtuar e shkollave ndaj nevojave lokale
- ✓ Zgjedhje e shtuar në shkollim
- ✓ Vijueshmëri dhe arritje më e mirë e nxënësve (përmes pjesëmarrjes së shtuar prindërore)
- ✓ Profesionalizëm më i madh i mësimitdhënësit
- ✓ Cilësi e përmirësuar arsimore (përmes përgjegjësisë së shtuar dhe burimeve shtesë)
- ✓ Demokratizim i përmirësuar dhe kohezion social brenda komunitetit
- ✓ Arritje e shkathtësive të reja në komunitet përmes pjesëmarrjes në menaxhim/qeverisje të shkollave
- ✓ Mjetet e implementimit të decentralizimit arsimor

Të gjitha shkollat bashkëpunojnë me komunat, pasi kjo është pjesë e përqendruar dhe e pandryshueshme e sistemit arsimor. Megjithatë, jo të gjitha shkollat shfrytëzojnë bashkëpunimin ndërmjet veti dhe rrjetëzimin si mjete për të ngritur efikasitetin e tyre, dhe jo të gjitha shkollat bashkëpunojnë me OJQ-të dhe institucionet jashtë shkollës ku bashkëpunimi nuk përcaktohet me ligj.

Shkollat mund t'i krijojnë Komunitetet e të Mësuarit së Bashku, në kuadër të cilit komunitet mund ta përgatisin planin e veprimit për aktivitete të perbashkëta. Gjithashtu mund të bashkëpunojnë me udhëheqësit ose përfaqësuesit e komunitetit, që tanimë janë identifikuar si pjesëmarrës aktiv në komunitet.

¹⁵ Proceset shkollore, pushteti lokal dhe pjesëmarrja e komunitetit. Të kuptuarit e qasjes "Qendra për Arsim Ndërkombëtar në Universitetin Sussex (Korrik 2007)

Partnerët bashkëpunues nga brenda dhe jashtë shkollës mund të jenë:

- Zyrtarët komunal (zyrtarët për çështje gjinore, zyrtarët për komunitete, etj)
- Qendrat dhe klubet e rinisë
- Qendrat e komunitetit/mësimimit
- OJQ-të
- Asociacionet e specializuara për punë me grupet e veçanta të marginalizuara
- Udhëheqësit e komunitetit
- Prindërit
- Familja (e ngushtë dhe e largët)
- Zyrtarët e zyrave për punë sociale
- Psikologët, pedagogët, mjekët dhe ekspertët për parandalim

5.3 Rregullat e sjelljes në shkollë

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Kosovë¹⁶ (2015), këshilli drejtues i shkollës duhet të dorëzojë propozimin me rregullat e shkollës në komunën përkatëse për miratim. Rregullat e hartuara duhet të nxisin sjelljen e mirë dhe disiplinën nga ana e nxënësve, dhe të promovojnë konceptin e një shkolle të shëndetshme duke eliminuar dhunën. Ne do të fokusohemi në rregullat e sjelljes në shkollë.

Praktika ka dëshmuar që me qëllim që të kemi një fillim të duhur të procesit të hartimit të rregullave të sjelljes në shkollë, për përfaqësuesit e shkollës, të angazhuar në procesin e hartimit të rregullave të sjelljes në shkollë, është e një rëndësie të veçantë që ata të analizojnë dhe t'iu japin përgjigje disa pyetjeve: Pse kemi nevojë për rregulla të sjelljes në shkollë? Cili është qëllimi i rregullave të sjelljes në shkollë? Si duhet të hartohen rregullat e sjelljes në shkollë? Kush duhet të jetë i përfshirë në hartimin e rregullave të sjelljes në shkollë? Si do të pasqyrohen rregullat e sjelljes në shkollë? Si do monitorohet procesi mbi zbatimin e rregullave të sjelljes në shkollë?

Përgjigja në këto pyetje na shpie neve tek një argument që shkollat duhet të përfshijnë palët e ndryshme në hartimin e rregullave të sjelljes në shkollë; ato duhet të përcaktojnë qëllimet e qarta të rregullave të sjelljes; ato duhet të hartojnë rregulla të qarta dhe të zbatueshme, dhe gjithashtu të monitorojnë zbatimin e tyre.

Përmes rregullave të sjelljes në shkollë ne qartësojmë sesi nxënësit, mësimdhënësit dhe personat tjerë të shkollës duhet të sillen dhe komunikojnë me njëri tjetrin.

¹⁶ <http://MASH.rks-gov.net/uploads/2015/06/1-ligji-per-arsimin-parauniversitar.pdf>

A. QËLLIMET E RREGULLAVE TË SJELLJES NË SHKOLLË



SHMANGUNI KONFLIKTIT ME RREGULLA

Qëllimi i rregullave të shkollës është të shmangen konfliktet përbrenda shkollës dhe zbatimi i dispozitave ligjore të dedikuara për nivelin përkatës të arsimit.

➔ Rregulloni atmosferën ku mësimdhënia dhe mësimnxënia janë të mundshme

➔ Rregulloni koekzistencën e nxënësve dhe mësimdhënësve në shkollë

➔ Janë rregulla të qarta për sjelljen

➔ Ata sigurojnë se drejtësia është në harmoni me dispozitat ligjore

➔ Bëni me dije qartazi të gjithëve se çka pritet nga ai/ajo

5.3.1. Procesi i hartimit të rregullave të shkollës

Procesi i hartimit të rregullave të shkollës duhet të mbështetet në rregulla ligjore. Drejtori i shkollës është përgjegjës të iniciojë procesin e krijimit të rregullave të shkollës. Rregullat e shkollës duhet të harmonizohen me Kodin e Mirësjelljes; Kodin e Etikës për Vlerësimin e Nxënësve dhe dokumente të tjera ligjore të hartuara nga MASH-i. Pyetjet kryesore që udhëheqin procesin e hartimit të rregullave të shkollës janë:

- ✓ Pse të hartohen rregullat e shkollës? Përgjigjja në këtë pyetje shpjen te specifikimi i qëllimit të rregullave shkollë.
- ✓ Kush duhet t'i hartojë rregullat e shkollës? Përgjigjja në këtë pyetje shpjen te përfshirja e të gjithë përfaqësuesve në procesin e hartimit të rregullave.
- ✓ Si të hartohen rregullat e shkollës? Me procesin e konsultimeve të adresohen ato si duhet.
- ✓ Kur të hartohen ato? Atëherë kur ne sigurojmë informata mbi procesin e hartimit dhe kur ne sigurojmë pjesëmarrje të palëve kryesore në procesin e hartimit.
- ✓ Kujt t'iu drejtohem për miratim? Këshillit Drejtues të Shkollës dhe Drejtorive Komunale të Arsimit, si institucione kompetente për t'i miratuar rregullat e hartuara nga shkollat.
- ✓ Çka pas miratimit? Monitorimi mbi zbatimin e rregullave, ndryshimi i tyre me rregulla shtesë dhe zyrtarisht të miratuara.
- ✓ Të analizojnë dhe kuptojnë sfidat specifike në shkollën e tyre.

Nuk është e mundshme ose e nevojshme të krijohen rregulla për çdo rast. Shkollat duhet të mendojnë për detyrën e tyre dhe detyrën e arsimit cilësor. Drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit janë përgjegjës për lëndë efektive dhe të suksesshme. Çdo nxënës ka të drejtë të arsimit në një atmosferë mirëbesimi, miqësore dhe nderimplotë. Prandaj të gjitha palët kryesore duhet të mendojnë rreth nevojave të arritjes së një kulture të tillë, ku mësimdhënia dhe mësimnxënia mund të ndodhin pa elemente tronditëse apo dhunë.

Për shembull një element me rëndësi për mësimdhënie dhe mësimnxënie është se orët e mësimit mund të fillojnë në mënyrë të përpiktë. Hapi tjetër është tani të dihet çka nevojitet që orët e mësimit të fillojnë në mënyrë të përpiktë dhe pse kjo është e rëndësishme. Nëse nxënësit vijnë tepër vonë është me rëndësi të dihet më shumë për këtë. Ndoshta ata kanë pasur lidhje të keqe me autobus apo ata kanë rrugë tepër të

gjata ndërmjet dhomave të ndryshme të shkollës. Dhe nëse mësime të ndryshme nuk janë shpesh të përpiktë është gjithmonë e nevojshme të dihet më shumë rreth arsyeve. Por nëse nuk ka arsye të mira, drejtori i shkollës duhet të menaxhojë sjelljen e tillë joprofesionale të personelit të tij/saj.

Ky shembull provon të tregojë që është e rëndësishme të diskutohen kushtet, të cilat janë të rëndësishme për nxënësit, mësime të ndryshme dhe drejtorin e shkollës me qëllim të arritjes së një shkolle të mirë dhe arsimit cilësor. Pas asaj, hapi tjetër është të mendohet rreth rregullave, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e qëllimeve sikur: “Orët e mësimit fillojnë me kohë të përpiktë, sepse nxënësit dhe mësime të ndryshme kanë të drejtë ta shfrytëzojnë kohën e tyre efektivisht.”

Është e rëndësishme në aspektin psikologjik të **formulohen rregullat në një mënyrë pozitive.**

Shembull i shkollës së mirë: Shkolla e mirë ka një sistem gjithëpërfshirës të kujdesit për nxënësit. Kjo shprehet në rregullat e sjelljes, të cilat hartohen në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për të gjithë. Parimi i respektit ndaj njëri-tjetrit vihet në qendër, pastaj respektimi i kulturave të tjera, parandalimi i abuzimeve, fyerjeve të ndryshme dhe aktet e dhunës, etj. Formulimi i rregullave të shkollave të mira vendoset në këtë mënyrë: p.sh. të gjithë fëmijët tanë shkollorë, pavarësisht dallimeve të tyre, pranohen dhe respektohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë në shkollë, nxënësit mund të shprehin lirshëm mendimet e tyre; shkolla duhet të organizojë mësime të ndryshme cilësore etj. Është e rëndësishme që këshilli i nxënësve dhe këshilli i prindërve së bashku me këshillin drejtues të shkollës të formulojnë rregulla individuale të shkollave, të cilat janë në përputhje me politikat e MASH-it.

Por nuk është e mundur të bëhet një listë e ndëshkimeve. Mësime të ndryshme kanë nevojë për hapësirë për zgjidhje pedagogjike dhe individuale të problemeve. E njëjta për drejtorët e shkollave, nëse nuk ka ndonjë rrezik për njerëzit apo dhunë. Përndryshe, nëse ka ndonjë rast rreziku, mësime të ndryshme dhe drejtorët e shkollave duhet të reagojnë në mënyrë ligjore ndaj një konflikti të tillë.

Kur rregullat e një shkolle krijohen nga të gjithë dhe përcaktohen në letër, atëherë

- A** Të gjithë pjesëtarët e shkollave dhe prindërit informohen rreth rregullave të shkollës.
- B** Çdo ndryshim në rregulla të shkollës i komunikohet secilit.
- C** Rregullat e shkollës u qartësohen kujdesshëm dhe me maturi veçanërisht nxënësve të vegjël.
- D** Bëhet shpallja publike e rregullave të shkollës.
- E** Rregullat e shkollës u dërgohen me shkrim çdo nxënësi (të ri), prindërve dhe mësime të ndryshme.

Shumë shkolla kanë rregulla, por vetëm disa prej tyre i zbatojnë

Ne shumë kënaqemi kur humbim orët mësimore, po ju? Madje edhe kur vonohemi askush nuk e regjistron mungesën tonë.

Ne kemi rregulla, por unë e njoh drejtorin e shkollës kështu që çdo here ia dal pa problem.

5.3.2. Trajtimi i konflikteve

Nganjëherë ka konflikte që duhet të menaxhohen në një mënyrë profesionale dhe efektive. Prandaj, është e nevojshme të profesionalizohet menaxhimi i konflikteve dhe metodat e komunikimit pa dhunë. Trajnime të tilla sociale për menaxhim të konflikteve, komunikim dhe ndërmjetësim mund të bëhen me të gjitha palët kryesore të shkollës.

Drejtorët e shkollave duhet të kenë trajnim të veçantë me këshillim të dispozitave ligjore, intervenimit dhe parandalimit. Për rastet ekstreme është e nevojshme që drejtori i shkollës të marrë mbështetje nga komuna dhe udhëheqësia e shkollës.

Korniza mbi menaxhimin e konfliktit për mësimdhënësit dhe drejtorin e shkollës është:

1. Palët në konflikt,
2. Përshkrimi i rasteve të konfliktit,
3. Rregullat e sjelljes në shkollë për të tejkaluar konfliktet dhe parandaluar ato,
4. Veprimet kur ka shkelje të rregullave, dhe
5. Dispozitat ligjore për të përkrahur adresimin e veprimeve në rastet e shkeljeve të rregullave të sjelljes në shkollë

AKTIVITETI 13

Praktikoni ushtrimin me role në dy situata si më poshtë:

- ➔ Dy nxënës diskutojnë me njëri-tjetrin në lidhje me shkollat e tyre të cilat kanë rregulla por nuk zbatohen, dhe si pasojë ka konflikte mes nxënësve dhe mësimitdhënësve.
- ➔ Dy mësimitdhënës diskutojnë për shkollën e tyre që nuk ka rregullat e sjelljes edhe pse ka konflikte të shpeshta në shkollë.

5.3.3. Monitorimi i zbatimit të rregullave të shkollës

Rregullat e hartuara nga shkolla duhet të monitorohen gjatë zbatimit përndryshe ato do të mbesin vetëm në letër.

Sipas Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar, shkollat duhet të mbikëqyrin sjelljen e çdo nxënësi individualisht.

Në bazë ditore, ky monitorim i sjelljeve të nxënësve është detyrë e mësimitdhënësve. Drejtori i shkollës, ka për detyrë të përkrahë dhe fuqizojë mësimitdhënësit në këtë punë sfiduese. Të dy, drejtorët e shkollave dhe mësimitdhënësit veprojnë në pajtim me Udhëzimet Administrative dhe informojnë DKA-n rreth nxënësve, të cilët nuk iu binden rregullave të sjelljes në shkollë. Për t'i integruar ata nxënës prapë në shkollimin normal, duhet marrë dhe monitoruar masat edukative.

Kjo duhet të përfshijë bisedat me prindërit e tyre dhe këshillin drejtues të shkollës, duke adresuar nxënësit te pedagogu i shkollës dhe psikologu, bazuar në UA 34/2014 MASH¹⁷. Funksionimi i shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla - psikologët e shkollave në mesin e përgjegjësive të tjera duhet gjithashtu të përdorin strategji efektive për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale që ndihmojnë nxënësit t'i kontrollojnë sjelljet e tyre. Nëse nuk janë ndërmarrë përpjekje të arsyeshme, prindi ka rastin të fitojë të drejtën nga Ministria kundër vendimit për transferim të nxënësit në shkollën tjetër.

Mësimitdhënësit dhe drejtori i shkollës duhet të monitorojnë vijueshmërinë e nxënësve dhe nëse ata vërejnë probleme, ata duhet të bëjnë analizën për shkaqet dhe të kërkojnë zgjidhje së bashku me organin përkatës të shkollës si PRTAN¹⁸. Hapi i fundit përfshin DKA-n.

Drejtori duhet të monitorojë sjelljen e mësimitdhënësve në lidhje me nxënësit dhe të sigurojë që krejt personeli kupton rëndësinë e punës së tyre dhe i inkurajon ata në punën e tyre. Drejtori duhet t'u bëjë

¹⁷ <http://MASH.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-34-2014.pdf>The

¹⁸ Ekipi për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit dhe dështimit në arsimin e detyrueshëm.

vizita të rregullta klasëve dhe të kuptojnë se puna vërtetë është duke shkuar përparasi pas standardeve të nevojshme të performancës.

Mësimdhënësit dhe mentorët (kujdestarët) e klasës duhet të monitorojnë vazhdimisht zbatimin e rregullores së shkollës lidhur me sjelljen e nxënësve në shkollë, respektimin e rregullave të brendshme dhe kodit të mirësjelljes.

5.4 Gjithëpërfshirja

Në këtë pjesë do të shqyrtojmë shkurtimisht disa aspekte të gjithëpërfshirjes si një element I rëndësishëm të kulturës së shkollës, pasi që do të ketë një modul të posaçëm për gjithëpërfshirje në shkolla.

Sipas UNESCO-s, gjithëpërfshirja është definuar si një proces i adresimit dhe reagimit ndaj diversitetit të nevojave të të gjithë nxënësve përmes rritjes së pjesëmarrjes në të mësuarit, kultura dhe komunitete, si dhe zvogëlimi i përjashtimit.

Në çdo shoqëri, sektori i arsimit duhet t'ua plotësojë nevojat grupeve të ndryshme të fëmijëve. Përderisa shumica e fëmijëve normalisht përfshihen nga shkolla, ekzistojnë disa grupe të fëmijëve, të cilët janë veçanërisht në rrezik nga përjashtimi. Në shumë vende kjo vlen për fëmijët nga grupet e ndryshme gjuhësore dhe pakicat etnike, nga zonat e largëta rurale, deri te fëmijët nga familje ekonomikisht të varfër dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Pabarazia gjinore është një çështje e mprehtë në çdo lloj të pengesës edukative.

Gjithëpërfshirja nuk ka të bëjë vetëm me ata fëmijë që nuk vijnë fare shkollën, por gjithashtu me ata fëmijë, të cilët regjistrohen në shkollë, por nuk e përfundojnë ciklin e plotë të arsimit fillor dhe mund të mos kenë pasur arsim të cilësisë së mirë. Kështu fëmijë në rrezik janë gjithashtu ata fëmijë, të cilët janë tërhequr herët dhe kanë nevojë për një mundësi të dytë për arsimim: arsimimi duhet të jetë i hapur për të gjithë, duhet të jetë gjithëpërfshirës. Gjithëpërfshirja i referohet adresimit të nevojave të të gjithë fëmijëve pa dallim. Kjo me pak fjalë do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t'u ofrohen mundësi të barabarta për arsim pa marrë parasysh gjuhën që flasin, besimin fetar, kombin që i takojnë, gjininë, apo ndyshueshmëritë që i kanë si pasojë e dëmtimeve të natyrave të ndyshshme fizike dhe psikike. Pra, secilit nxënës i jepet mundësia për të mësuar së bashku me të tjerët në cdo nivel arsimit.

Objektivi i parë i PSAK-ut¹⁹ 2017 - 2021 është Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja. Ky objektivi adreson rëndësinë e rritjes së mundësive për gjithëpërfshirje dhe të drejtat e barabarta për zhvillim dhe edukim për çdo nxënës në arsimin parauniversitar të Kosovës.

¹⁹ Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2016): Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

6. Fokusi mbi Strategjinë e Zhvillimit të Cilësisë

Qeveria e Kosovës ka miratuar “Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar 2016-2020”. Qëllimi i kësaj strategjie është që të sigurohet themelimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm të sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar, i cili do të kontribuojë në një sistem më të mirë arsimor dhe performancë më të lartë.

Sigurimi i cilësisë është një përgjegjësi e përbashkët e tri subjekteve të ndryshme të arsimit:

- 1 Inspektoratit të Arsimit (MASH)
- 2 Drejtorisë Komunale për Arsim
- 3 Shkollave

Lidhur me përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektoratit të Arsimit dhe DKA-ve, ekziston një përshkrim i hollësishëm në UA për Sigurimin e Cilësisë dhe në Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar 2016-2020”, ndërsa në këtë modul do të shqyrtojmë rolin e shkollave për të kontribuar në cilësinë e arsimit.




Figura 6.1 Cikli i cilësisë: Doracak për Sigurimin e Cilësisë në Shkolla (MASHT, 2016)

6.1 Sigurimi i cilësisë në nivel të shkollës

Cilësia e shkollës është e ndërlidhur me rezultatet e performancës së shkollës në pesë fushat e cilësisë të përmendura në kapitullin 1 dhe të shqyrtuara më hollësisht në Kornizën (Shtojca B): 1) Menaxhimi dhe qeverisja, 2) Kultura dhe mjedisi shkollor, 3) Mësimdhënia dhe mësimnxënia, 4) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe 5) Performanca e nxënësve. Strategjia e Zhvillimit të Cilësisë duhet të jetë prioritet i Planit Zhvillimor të Shkollës bazuar në UA 23/16 për Sigurimin e Cilësisë dhe Kornizën për Sigurimin e Cilësisë (MASH, 2016).

Plani i zhvillimit të cilësisë duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, i cili duhet të integrohet në planin zhvillimor të shkollës, i cili përgatitet nga ekipi shkollor i themeluar nga drejtori i shkollës dhe zbatohet me ndihmën e koordinatorit të cilësisë dhe drejtuesve të departamenteve profesionale. Zhvillimi i cilësisë bazohet në ciklin e cilësisë: Planifiko - Bëj - Kontrolllo - Vepro.

- ✓ Plani bazohet në UA për Planin Zhvillimor të Shkollës dhe përcakton vizionin, misionin dhe qëllimet për përmirësimin e shkollave dhe fushave të cilësisë.
- ✓ Bëj dhe Kontrolllo bazohen në planin vjetor të veprimit të shkollës dhe instrumentet për vetëvlerësimin e fushave të cilësisë, për të vlerësuar nëse janë arritur synimet vjetore.
- ✓ Vepro nënkupton rishikimin e planit vjetor bazuar në raportin e vetëvlerësimit.

6.1.1 Personeli shkollor përgjegjës për koordinimin e cilësisë në shkollë

Në mënyrë që plani i zhvillimit të cilësisë së shkollës të zbatohet me sukses, këta janë njerëzit përgjegjës brenda shkollës:

- ✓ Drejtori i shkollës
- ✓ Pedagogu, psikologu, koordinatori i cilësisë
- ✓ Mekanizimi për vlerësimin e shkollës
- ✓ Aktivat profesionale

Për më shumë informata mbi përgjegjësitë e tyre, ju lutemi t'i referoheni dhe/ose t'ua dorëzoni pjesëmarrësve Doracakun për Sigurimin e Cilësisë në Shkollë (MASH, 2016).

6.2.Roli i drejtorit të shkollës në krijimin e kulturës bashkëpunuese me të gjithë e për të gjithë

Roli i drejtorit të shkollës konsiston ndër të tjera edhe në krijimin e frymës bashkëpunuese midis të gjithë faktorëve mësimorë në radhë të parë me bashkëpunëtorët profesional: pedagogun apo psikologu. Secili nga faktorët kërkohet të aftësohen për të qenë pjesë e “rrjetit” nëpër të cilin mundësohet krijimi i kontakteve të suksesshme me të tjerët. Aftësia e sajimit të rrjeteve me partnerët social (familjen, komunitetin, tregun e punës, afaristët, etj.), siguron perspektivë të qartë për individin dhe për shoqërinë.

Për sigurimin e funksionimit të mirë të shkollës si organizatë e suksesshme, bashkëpunimi brenda dhe jashtë institucional është komponent me rëndësi. Drejtori i shkollës duhet të inkurajojë bashkëpunim me: Këshillat e prindërve, Këshillat e nxënësve, Aktivet profesionale, Përfaqësuesit e komunitetit, etj..

Bashkëpunimi i shërbimit profesional me organet qeverisëse dhe profesionale në shkollë, kërkon njohje të mirë të detyrave, përgjegjësi dhe të detyrimeve të tjera ligjore që janë përcaktuar për secilin organ në shkollë, kërkon njohje të mirë të praktikave të bashkëpunimit, të kulturës së shkollave dhe komunitetit në të cilin gjinden shkollat.

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Kosovë (2011) Këshilli drejtues i shkollës është organi më i lartë këshillëdhënës dhe vendimmarrës në shkollë. Anëtarët e këshillit drejtues janë vullnetarë që angazhohen pa pagesë të cilët përfaqësojnë dhe janë përgjegjës ndaj klientëve (familjeve dhe nxënësve), komunitetit të gjerë, akterëve relevant (qeverisjes lokale dhe qendrore), si dhe taksapaguesve.

Këshilli i prindërve paraqet një organ këshillëdhënës të shkollës. Qëllimi primar i Këshillit të prindërve është ngritja e bashkëpunimit dhe forcimi i partneritetit ndërmjet komunitetit të prindërve dhe të shkollës si institucion arsimor. Partneriteti i këshillit të prindërve dhe i shkollës i kontribuon edhe ngritjes së cilësisë në veprimtarinë edukativo-arsimore por edhe në avancimin e sistemit arsimor përgjithësisht.

Këshilli i prindërve konsiderohet hallkë me rëndësi të veçantë në funksionimin efikas të shkollës si institucion. Konstituimi i tij bëhet në harmoni me Rregulloren përkatëse të shkollës.

Këshilli i nxënësve paraqet një organ i cili përfshinë të gjithë nxënësit e shkollës dhe ka për qëllim krijimin e partneritetit me shkollën. Qëllimi primar i Këshillit të nxënësve është përkujdesja për respektimin e të drejtave dhe përgjegjësi të nxënësve.

Këshilli i nxënësve është organ me rëndësi për funksionimin e shkollës. Konstituimi i tij bëhet në harmoni me Rregulloren përkatëse të shkollës. Detyrat e Këshillit të nxënësve janë si në vijim:

- ✓ Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe përgjegjësi të nxënësve;
- ✓ Nxitja e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në punën e shkollës;
- ✓ Bashkëpunimi me drejtorin, Këshillin e prindërve dhe me shkolla tjera;
- ✓ Promovon interesat e shkollës në mjedisin në të cilin shkolla funksionon;

- ✓ Propozon dhe organizon aktivitete vullnetare me karakter edukativ, argëtues etj.; dhe
- ✓ Krijon ura bashkëpunimi me organizata njëra të cilat merren me çështje rinore.

Bashkëpunimi dhe komunikimi me prindër nënkupton shkëmbimin e informacioneve në baza ditore, javore, mujore, varësisht nga problemet për sjelljen, suksesin dhe ndryshimin moshor të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen fizike dhe në suksesin e fëmijës.

6.3. Roli i pedagogut dhe psikologut në shkollë²⁰

Roli i drejtorit të shkollës konsiston ndër të tjera edhe në krijimin e frymës bashkëpunuese midis të gjithë faktorëve mësimorë në radhë të parë me bashkëpunëtorët profesional: pedagogun apo psikologu. Secili nga faktorët kërkohe

AKTIVITETI 14

Lexoni në tekstin në vijim punët dhe detyra e pedagogut dhe të psikologut të shkollës. Pas leximit individual, në grup hartoni një skicë të planit të bashkëpunimit me pedagogun apo psikologun (apo me të dytë) për të përmirësuar cilësinë e të nxënësve dhe mësimdhënies në shkollën tuaj.

Pedagogu dhe psikologu i shkollës janë të thirrur dhe kanë përgjegjësi për të ofruar këshillime dhe shërbime tjera profesionale në shkollë, në përputhje me frymën e re të shërbimit pedagogjik psikologjik dhe veprimtaritë e lidhura me zbatimin e reformës arsimore. Kjo përgjegjësi kërkon që pedagogu dhe psikologu i shkollës të ruajnë dhe zhvillojnë standarde të larta të sjelljeve profesionale. Puna duhet të organizohet në atë mënyrë që këshillimet e veprimet praktike të pedagogut dhe psikologut të shkollës të hetohen dhe të çmohen nga nxënësit, mësimdhënësit, prindërit, bashkëpunëtorët profesional dhe gjithë komuniteti arsimor.

Roli i shërbimit pedagogjik - psikologjik në shkollë, ndryshon krahas me rolin e ri të shkollës të përcaktuar me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kornizën për Sigurimin e cilësisë së arsimit parauniversitar dhe politikave tjera zhvillimore të arsimit që kanë në fokus përkrahjen e të nxënësve të nxënësve.

²⁰ Grup autorësh (2016). Shërbimi Pedagogjik dhe Psikologjik në Shkollë. Prishtinë: Basic Education Program.

Grup autorësh (2016). Puna e pedagogut të shkollës. Prishtinë: Basic Education Program.

Grup autorësh (2016). Puna e pedagogut të shkollës. Prishtinë: Basic Education Program.

Roli i shërbimit pedagogjik - psikologjik në shkolla, në mënyrë të veçantë është përcaktuar me udhëzim administrativ (UA, 2014) sipas të cilit pedagogu dhe psikologu i shkollës kanë rol të veçantë në organizimin e punës në shkollë dhe duhet të marrin pjesë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe realizimin e punës së gjithëmbarshme në shkollë, si: planifikim e programim të punës mësimore, hulumtim, monitorim, analizë e vlerësim të punës në shkollë, realizim efektiv të procesit edukativo-arsimor, punë e drejtpërdrejtë me nxënës, mësimdhënës, prindër, komunitet, institucione e organizata qeveritare dhe joqeveritare, zhvillim profesional të stafit të shkollës, zhvillim profesional personal, në zhvillim të projekteve, etj.

Në kuadër të shërbimit pedagogjik-profesional në shkolla, pedagogu dhe psikologu, përveç punës së përbashkët kanë edhe rol dhe punë të veçantë, varësisht nga profili i përgatitjes profesionale. Puna e **pedagogut të shkollës** në udhëzim administrativ për shërbimin pedagogjik - psikologjik përcaktohet si vijon:

- ✓ Pedagogu kontribuon në realizimin dhe përparimin e punës edukativo-arsimore në institucione shkollore në harmoni me ligjet dhe dokumentet pedagogjike të MASH, si: Korniza e Kurrikulit të Kosovës, Kurrikula bërthamë dhe dokumente tjera relevante.
- ✓ Pedagogu i shkollës është ekspert i cili me punën e tij i kontribuon lehtësimit të problemeve të ndryshme që shfaqen në shkollë si tek nxënësit, mësimdhënësit, prindërit apo të gjithë akterët tjerë shkollor si dhe kontribuon në ngritjen e cilësisë së veprimtarisë edukative-arsimore.

Pedagogu i kryen këto punë:

- Planifikimi, programimi dhe organizimi i punës edukativo-arsimore;
- Mbështetja e hartimit dhe zbatimit të planit zhvillimor të shkollës;
- Koordinimi i punës të aktiveve profesionale , planprogramin e mësimdhënësve;
- Përkrahë klubet e nxënësve, këshillat e prindërve dhe organet apo këshillat tjerë të shkollës;
- Merr pjesë në hulumtimin e nevojave arsimore, në hartimin dhe zbatimin e projekteve shkollore;
- Përcjell dhe inkurajon futjen e risive dhe praktikave të mira pedagogjike.

Ndërsa, puna e **psikologut të shkollës** në udhëzimin administrativ për shërbimin pedagogjik-psikologjik përvijohet si në vijim:

- ✓ Psikologu kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënësve dhe promovon zhvillimin kognitiv,emocional, social dhe personal të nxënësve;
- ✓ Psikologu ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë.

Psikologu i kryen këto punë:

- Psikologu ka për detyrë të vlerësojë dhe interpretojë çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënësve dhe zhvillimin kognitiv, social, personal dhe emocional të nxënësve;
- Psikologu asiston dhe ofron ndihmë në identifikimin e nxënësve me vështirësi në të nxënësve, nxënësve të talentuar, identifikon dhe vlerëson nevojat e nxënësve, bashkëpunon me profesionistë të tjerë dhe zbaton vlerësime të përshtatshme (të besueshme dhe valide); zhvillon intervista

me nxënës, mësimdhënës e prindër; vëzhgime e procedura të ndryshme me qëllim të vlerësimit objektiv dhe propozon e zbaton masa për intervenime psikoedukative individuale dhe në grup.

AKTIVITETI 15

Duke përdorur analizën SWOT, kërkoni nga grupi që të vlerësojnë shkollën e tyre kundrejt pesë fushave të cilësisë.

→ Strategjia për Zhvillim të Cilësisë është një pjesë thelbësore e arritjes së përmirësimit në shkollë. Kjo strategji duhet të zhvillojë dhe riafirmojë vizionin dhe vlerat, dhe të përcaktojë qëllimet konkrete dhe rezultatet që do të paraqisnin arritjen e vizionit të shkollës. Me vizionin e saj shkolla do të kishte një strukturë të qartë të drejtimeve dhe pritjeve brenda së cilave mund të gjendet një strategji e tërë.

6.4. Vizioni i shkollës

- ✓ Një vizion është si një “fushë e forcës” e besimeve të ndara që “tërheq” njerëzit të punojnë së bashku.
- ✓ Koncepti i vizionit është të krijojë realitete nga ëndrrat dhe ëndrrat nga realitetet.
- ✓ Vizioni sjellë drejtimin
- ✓ Vlerat veprojnë si një ‘kompas’ moral për të siguruar që sjelljet të jenë të duhura
- ✓ Besimet i përcaktojnë veprimet për ta realizuar vizionin
- ✓ Në rastet e vizionit për një shkollë të mirë pyetja është?
- ✓ Çfarë shkollash ideale ne duam të krijojmë?
- ✓ Çfarë është shkolla jonë e ëndrrave?
- ✓ Çfarë është shkolla në të cilën ju do të dëshironit të jepnit mësim, ndjeknit apo dërgonit fëmijët tuaj?
- ✓ Nuk duhet të kufizohemi në atë sesi shkollat duken sot.

AKTIVITETI 16

Puna grupore: Vizatoni një shkollë të mirë pa komunikuar me njëri-tjetrin

Ndërsa diskutohet për vizionin e shkollës është shumë e rëndësishme të përfshihet një varg i gjerë i palëve, siç janë: udhëheqësia e shkollës, mësimdhënësit, nxënësit, Këshilli Drejtues i Shkollës, prindërit, Këshilli i Nxënësve dhe komuniteti, dhe kjo kërkon veprime të përbashkëta, veçanërisht nga njerëzit kyç në shkollë - dhe natyrisht përkushtim të plotë të të gjitha palëve. Të gjithë të përfshirët duhet të shohin përfitimin nga zhvillimi i një vizioni të tillë dhe të shihet që pasqyrohet në: vlerat, në të cilat shkolla beson (siç shihet nga sjelljet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve).

Çka është e rëndësishme dhe akoma mungon, në jetërat tona është koncepti i qeverisjes së përbashkët, një term siç është Qeverisja e Komunitetit. Në esencë ky është një proces i dialogut aktiv, në të cilin njerëzit angazhohen në të kuptuarit që ata lenë anash dallimet dhe aktualisht dëgjojnë pikëpamjet e njerëzve tjerë.

Jo vetëm procesi i dialogut është i rëndësishëm, por gjithashtu një pranueshmëri se krahas me fjalët vjen një përgjegjësi për të pranuar angazhimin që do të kërkojë veprime dhe për të raportuar mbi këto veprime. Ka shpesh raste kur ju do të keni një situatë ku të gjithë pajtohen me përfundimet, por atëherë ua lenë punën të tjerëve. Shkollat janë një nga vendet më të mira për të rivendosur qeverisjen e komunitetit, thjeshtë për shkak të natyrës së familjes dhe marrëdhënieve të zgjeruara familjare që e bëjnë një shkollë, në mënyrë që të përfshihet shumica e palëve dhe t'ia jep ndjenjën që secila palë është pjesë e saj.

Nga ajo çfarë është paraqitur, një grup mund të emërohet (udhëheqësit e grupit) dhe të paraqiten ide së bashku për të hartuar një draftvizion. Ndryshime mund të bëhen por në një pikë, draftvizioni duhet të pranohet dhe të ndërmerren veprime të pajtuara për t'a zbatuar atë. Kjo mund të jetë pjesë e Planit Vjetor Zhvillimor të Shkollës apo Planit Strategjik në vazhdim.

Forma finale e vizionit, vlerave dhe besimeve mund të mos përfundohet për një vit apo dy vjet, por për një periudhë më të gjatë dhe do të shihet e mbjellur vetëm përmes veprimeve të të gjithë të interesuarve.



Nuk është më e madhja, më e ndritura, më e mira që do të mbijetojë, por ato që përshtaten më së shpejti’.

Charles Darwin

Konkludimi:

Ky Modul është pjesë e kursit të menaxhimit të shkollës dhe është hartuar si një doracak për pjesëmarrësit e kursit dhe gjithashtu si një udhëzues për drejtorët e shkollave që mund t'u shërbejë atyre në baza ditore. Niveli i hollësive është përshkruar me aktivitete praktike për t'u ndihmuar pjesëmarrësve gjatë shtjellimit të tij. Pjesëmarrësit inkurajohen të përdorin gjykimin dhe ekspertizën e tyre profesionale dhe ta plotësojnë këtë modul me module të tjera për kursin e menaxhimit të shkollës dhe burime të tjera në dispozicion të miratuara nga MASH-i.

✓ FJALORTHI

- **ARRITJA** – përqindja e përbushjes së objektivave të caktuara, për shembull, objektivave të shkollës, objektivave të projektit, objektivave të programit trajnues, objektivave të njësive mësimore, etj.
- **EFEKTIVITETI** – shkalla e arritjes së rezultateve të synuara në sasi dhe cilësi, për shembull, shkalla e përbushjes së objektivave të mira të shkollës. “A jemi duke i bërë gjërat e duhura?”
- **EFIKASITETI** – raporti në mes të arritjeve dhe burimeve të nevojshme – efikasiteti është i lartë kur ne arrijmë rezultate të mira me shpenzime minimale të kohës dhe parave. “A jemi duke i bërë gjërat ashtu si duhet?”
- **INSTRUMENTI VLERËSUES** – një formë që i mundëson vlerësuesit për të përcaktuar shkallën e arritjes së rezultateve të mësimin. Një kombinim në mes të aftësive dhe të të kuptuarit kognitiv dhe metakognitiv, shkathësive ndërpersonale, vlerave intelektuale dhe praktike si dhe atyre etike.
- **KOMPETENCA** – një kombinim dinamik i aftësive dhe të të kuptuarit kognitiv dhe metakognitiv, aftësive ndërpersonale, vlerave intelektuale dhe praktike si dhe atyre etike.
- **KONTROLLI I CILËSISË** – mekanizmat dhe procedurat e veçanta, të cilat përdoren për kontrollin e cilësisë së arsimit, cilësisë së shkollës dhe procesit të mësimin.
- **MBIKËQYRJA** – një mekanizëm që u ofron informata të vazhdueshme mbi zhvillimet palëve të interesit të të gjitha niveleve.
- **MËSIMI ELEKTRONIK** – i referohet përdorimit të teknologjisë së internetit apo wireless, përdorimit të kompjuterit përmes internetit apo intranetit në marrjen apo shpërndarjen e informative përkatësisht përmbajtjeve.
- **MËSIMI ONLINE** – lloji i “ të nxënimit dhe mësimdhënies në distancë”, është term ‘ombrellë’ për çdo mësim që zhvillohet në distancë dhe jo në një klasë tradicionale.

- **MONITORIMI** - një proces i krahasimit të vazhdueshëm të rezultateve të parashikuara me rezultatet aktuale. Procedurat e rregullta sistematike për grumbullimin e informatave për aspektet e ndryshme edukative. Qëllimi i monitorimit është që të ndihmojë në efikasitetin dhe efektshmërinë e punës së shkollës.
- **STANDARDET** - deklarimi i objektivave që përkufizojnë një grup të arritshmërisë; një grup i deklaramëve që përkufizojnë se çka duhet të dinë palët e interesit dhe çfarë ato duhet të jenë në gjendje të bëjnë në sistemin arsimor.
- **TREGUESIT** - aksionet e dukshme, sjellja ose provat tjera që tregojnë praninë, gjendjen ose kushtet që kanë lidhshmëri me standardet. Treguesit mund të përdoren për vlerësimin e zhvillimit drejtë arritjes së standardeve.
- **TREGUESIT E CILËSISË** - një sistem i treguesve sasiorë dhe cilësorë që përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e arsimit në nivele të ndryshme.
- **VETËVLERËSIMI** - është një proces gjatë të cilit një institucion, agjenci, program apo individ mbledh informata për veten dhe bënë vlerësimin e tyre.
- **EVALUIMI** - në përgjithësi nënkupton kur diçka vlerësohet nga dikush në një mënyrë të caktuar dhe sipas disa kriterëve të caktuara. Është një proces gjatë të cilit përcaktohen vlerat në bazë të procesit të mbledhjes së informatave dhe të bërjes së matjeve.
- **VËZHGIMI** - është një proces normal i vëzhgimit të individëve gjatë një aktiviteti të caktuar, apo gjatë ngjarjeve dhe situatave të ndryshme në mjedise të ndryshme, dhe në shkolla. Vëzhgimi mund të jetë në formë të përshkrimit të lirë.

Referencat

- ➔ Grup autorësh (2006): Arsimi fillor cilësor, Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë
- ➔ Ainscow, M., dhe të tjerët, “Përmirësimi i shkollës, zhvillimi i gjithëpërfshirjes”, 2006
- ➔ Kuvendi i Kosovës (2006): Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional nr. 02/L-42
- ➔ Kuvendi i Kosovës (2004): Ligji për Inspektimin e Arsimit në Kosovë nr. 2004/37
- ➔ Kuvendi i Kosovës (2011): Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë nr. 04/L-032
- ➔ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008): Ligji për Arsimin në Komunat e Kosovës nr. 03/L-068.
- ➔ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008): Ligji për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060.
- ➔ Booth, T., dhe të tjerët, “Indeksi i gjithëpërfshirjes”, 2006
- ➔ Stenke, D. (2008): Bazat e vlerësimit, ligjërata e mbajtur me zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Prishtinë.
- ➔ Elisabeth Backman dhe Bernard Trafford (2007): Qeverisja demokratike e shkollave, Këshilli Evropian, Strasburg.
- ➔ Fullan, M. (1999): Forca e ndryshimit në arsim, Adea, Prishtinë.
- ➔ Fullan, M. (2001): Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim, Edualpa, Prishtinë.
- ➔ Goddard, T., Duraku, N., Ninaku, Xh. (2006): Informata mbi menaxhimin e arsimit, Udhëzues për Trajnerë, KEDP, Prishtinë.
- ➔ Grillo, prof.dr.Kozma (2002): Fjalor i Arsimit (Psikologji - Sociologji - Pedagogji), “Drita 2000”, Prishtinë.
- ➔ W.Baumann, H. (2004): Shkolla e mirë, GTZ, Prishtinë.
- ➔ Hallinger, P. &. (2010). Udhëheqja për mësimdhënien: A sjellë dobi udhëheqja bashkëpunuese në përmirësimin e shkollës? Administrimi dhe udhëheqja e menaxhimit të arsimit, 654-678.
- ➔ Hyseni, H., Salihaj, J., Nikoleta, M., Pupovci, D., (2003): Qeverisja dhe menaxhimi në arsim, KEC, Prishtinë.
- ➔ Koliqi, Hajrullah (2004): Sistemi arsimor i Kosovës, Libri shkollor, Prishtinë.

- Koliqi, Hajrullah (2004): Sistemi arsimor i Kosovës, Libri shkollor, Prishtinë.
- Gertsch, L., (2009), “Rregullimi i bazës në mënyrë të duhur - Kontributi i zhvillimit të fëmijërisë së hershme për cilësinë, barazinë dhe efikasitetin në arsim”,
- Mullford, B. (2008). Përmirësimi i të nxënësve në shkollë. Victoria: Acer Press.
- Rezultatet e PISA 2015 (Vëllimi II): Politikat dhe praktikat për shkollat e suksesshme. Qeverisja e shkollës, vlerësimi dhe llogaridhënia.
- Raport për Arritjet e Nxënësve të Kosovës në PISA 2015 (MASH, 2016)
- Stoll, L., Fink, D., & Earl, L. (2002). Pse mësimnxënien ka të bëjë me mësimnxënien (dhe me kohën): Çfarë ka në të për shkollat? Londër: RoutledgeFalmer
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2004): Korniza e standardeve të praktikës profesionale për mësimdhënësit në Kosovë,
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2010): Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve (2010).
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2011): Korniza e Kurrikulës për Arsimin Parashkollor, Fillor dhe të Mesëm, Prishtinë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Programi i Arsimit Fillor (BEP/USAID, 2012): Kodi i Etikës për Vlerësim
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Programi i Arsimit Fillor (BEP/USAID, 2012): Standardet e Vlerësimit në Shkollë
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Programi i Arsimit Fillor (BEP/USAID, 2012): Vlerësimi për mësimnxënien
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Programi i Arsimit Fillor (BEP/USAID 2016): Vlerësimi i bazuar në Kurrikulën e Kosovës
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2016): Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017- 2021
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2016): Strategjia e Sigurimit të Cilësisë 2016 – 2020
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës: Doracaku për Sigurimin e Cilësisë në Shkollë (2016)
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës: UA 08/16 – Vlerësimi i nxënësve bazuar në Kurrikulën e Re

- ➔ Flores, M. A. (2020) Preparing teachers to teach in complex settings: opportunities for professional learning and development, *European Journal of Teacher Education*, 43:3, 297-300, DOI: 10.1080/02619768.2020.1771895.
- ➔ Naidu, E-learning – A Guidebook of Principles, Procedures and Practices. Commonwealth of Learning (PDF).
- ➔ Stern, J. Introduction to Online Teaching and Learning, PDF
- ➔ National Education Association, Guide to teaching Courses (PDF).
- ➔ Qasja për Zhvillimin e Integruar të Shkollës – Koncept document (ISDA)
- ➔ Grup autorësh (2016). Shërbimi Pedagogjik dhe Psikologjik në Shkolla. Prishtinë: Basic Education Program,
- ➔ Grup autorësh (2016). Puna e pedagogut të shkollës. Prishtinë: Basic Education Program,
- ➔ Grup autorësh (2016). Puna e psikologut të shkollës. Prishtinë: Basic Education Program,
- ➔ The Characteristics Of A Good School, <https://ëëë.teachthought.com/learning-models/the-characteristics-of-a-good-school-great-school/>
- ➔ Zabeli, N., & Hoti, D. (2013). Aspekte pedagogjike dhe strategji të ndërvepruese të mësimdhënies. Prishtinë: Norwegian Embassy.
- ➔ 20 Observable Characteristics Of Effective Teaching, <https://ëëë.teachthought.com/pedagogy/20-observable-characteristics-of-effective-teaching/>
- ➔ Ministria e Arsimit dhe Shkencës: UA 22/16 Aktivat profesionale
- ➔ Ministria e Arsimit dhe Shkencës: UA 26/16 Plani Zhvillimor i Shkollës
- ➔ Ministria e Arsimit dhe Shkencës: UA 14/2013 Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve
- ➔ Ministria e Arsimit dhe Shkencës: UA 10/2013 Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve
- ➔ Ministria e Arsimit dhe Shkencës: UA 25/2014 Licencimi i Mësimdhënësve
- ➔ Nisma e OKB-së për edukimin e vajzave «Barazia dhe Gjithpërfshirja në Arsim», 2010
- ➔ UNESCO, “Barazia dhe gjithpërfshirja në arsim - Instrumentet për të mbështetur planifikimin dhe vlerësimin e sektorit të arsimit”, 2008
- ➔ UNESCO. (2015). <http://en.unesco.org/themes/learning-live-together>.

Shtojcat

Shtojca 1: Vlerësimi për mësimnxënie

Tregimi i vërtetë

Pas dymbëdhjetë viteve në shkollë dhe mbi gjashtë vite në universitet, nuk mbaj mend një gjë që kam studiuar si përgatitje për provimet përfundimtare (vlerësimi përmbledhës). Por e mbaj mend si sot përvojën time të parë me vlerësimin formues (formativ). Përvoja ka qenë me babain tim (i cili nuk ishte mësimdhënës).

Familja jonë ishte gati të shkonte në pushimin tonë të parë ndonjëherë larg shtëpisë. Isha dhjetë (10) vjeç. Kishim një veturë të vogël dhe nuk kishte vend për të gjitha valixhet. Pra, babai im vendosi që në të ndërtojmë një kuti të hapur për bagazh dhe ta vendosim kutinë në tavanin e veturës. Ai më pyeti nëse unë do të doja t'a dizajnoja dhe m'i dha specifikimet e saj:

- 1 Ne kishim dy dërrasa që ishin 2.5 metra të gjatë, 2 centimetra të trashë dhe 30 centimetra të gjerë. Këto dy dërrasa duhej të bëheshin muret e kutisë.
- 2 Pjesa e fundme e kutisë do të duhej të ishte me hapësirë ndërmjet dërrasave, kështu që nëse do të na zinte shiu, uji do të dilte në tavanin e veturës.
- 3 Pjesa e fundme me dërrasa që kishin hapësirë në mes tyre do të duhej të formonte bazën e kutisë dhe kutia do të duhet të montohet duke përdorur nyje të puthitura. Ne duhej të bënim 8 dërrasa të shkurtra për ta bërë këtë nga 3 copë lëndë druri që ishin 2.5 metra të gjatë, 2 centimetra të trashë dhe 10 centimetra të gjerë.

Pra, fillova me llogaritjet dhe dizajnimin; “Kjo do të jetë punë e lehtë, ose së paku kështu mendoja”. Ndërsa isha duke punuar, e pashë se kishte më shumë punë nga se mendoja, babai im kurrë nuk më thoshte “Kjo është gabim”. Ai bënte pyetje si: “Nëse e bën kutinë kaq të gjerë a do të përshtatet në tavan? “Nëse e bën pjesën fundore aq të gjatë a do të kesh lëndë druri të mjaftueshme?” Ai vazhdimisht më parashtronte pyetjet që më shtynin të mendoj “brenda kutisë”. Me fjalë të tjera, ai vazhdonte të më kthejë tek kriteret tona si objektivat e mësimin në një njësi mësimore. Brenda një dite e kisha projektuar kutinë. Dizajni funksionoi dhe së bashku e ndërtuam atë. Isha aq krenar dhe i ngazëllyer që “e kisha bërë kutinë”. Gjatë gjithë kohës isha duke mësuar nën udhëzimin e babait tim.

Vlerësimi Formues – Vlerësimi për të nxënë

Ajo që babai im kishte bërë ishte se ka përdorur vlerësimin klasik formues. Mësimdhënësit do të duhej ta bënin këtë gjithashtu çdo ditë me nxënësit. Ai

- Më ka siguruar informata kthyesë jogjyquese, faktike, përshkruese dhe inkurajuese.
- Më ka angazhuar në procesin e dizajnit;
- Ai më ka ndihmuar të zbuloj gabimet e mia, duke u siguruar se i kuptoja kufizimet që kishim dhe duke u siguruar se e dija hapin e ardhshëm. Po e krahasoja punën time me një synim; Ai siguroi se e kuptoja synimin (përshkrimin teknik të dizajnit)
- Kam marrë veprime për t'i korrigjuar gabimet;
- Unë isha në krye të të nxënësit tim.

Vlerësimi formues është mjeti më i fuqishëm i vlerësimit në gjenerimin e të nxënësit. Ai “... u jep nxënësve mundësinë për të qenë nxënës pa pasur frikën e dështimit. Krijon një mjedis mësimor dhe u ofron nxënësve mundësitë t'i praktikojnë aftësitë dhe të marrin informata kthyesë specifike dhe përshkruese të dizajnuara për të përmirësuar të nxënësit e tyre²¹. “Mjeti nuk është i fuqishëm vetëm për mësimnxënien, ai është në fakt një mjet diagnostikues për mësimdhënësit. Për të ditur nëse nxënësit po i kuptojnë aftësitë dhe konceptet që po shqyrtohen, u ndihmon mësimdhënësit të vendosin se çfarë duhet bërë tjetër. Mësimdhënësia nuk ka të bëjë me shpërndarjen e përmbajtjes; ajo ka të bëjë me angazhimin e nxënësve në aktivitete që i bëjnë ata të mësojnë.

Nëpërmjet vlerësimit formues, mësimdhënësit krijojnë një mjedis hulumtues duke parashtruar pyetje që nxënësit mendime dhe inkurajojnë nxënësit që të bëjnë të njëjtën gjë. Nxënësve u paraqiten mundësitë për të eksploruar dhe hulumtuar problemet ose sfidat e hapura. Mësimdhënësia kuptimplote vijon kur nxënësit fitojnë qasje në informata që ata kërkojnë për të zgjidhur problemin ose sfidën, kanë mundësi të mendojnë në mënyrë kritike dhe kreative, të bëjnë pyetje, t'i sfidojnë supozimet, të nxjerrin dhe të provojnë konkluzionet dhe të angazhohen në dialog për të nxënësit e tyre. Një mjedis i tillë i inkurajon nxënësit që të marrin një rol aktiv për të drejtuar dhe fokusuar mësimnxënien e tyre²².

Duke pasur parasysh se vlerësimi për mësimnxënien (vlerësimi formues) është një mjet i fuqishëm mësimor, drejtorët duhet të inkurajojnë përdorimin e tij. Në fakt, drejtorët duhet të presin përdorimin e tij nga të gjithë mësimdhënësit e shkollës, pavarësisht nga disiplina lëndore. Drejtori nuk duhet të jetë ekspert në disiplinë ose në vlerësim. Drejtori duhet të dijë mjaftueshëm sa për t'i bërë pyetje të duhura mësimdhënësit.

Thelbi i vlerësimit për mësimnxënien janë informatat kthyesë. Çfarë duhet të shihni kur vizitoni klasat? Cilat sjellje të mësimdhënësit duhet të vëzhgohen më së shpeshti? Listat e mëposhtme e karakteristikave dhe formave të informatave kthyesë janë kopjuar nga kapitulli 10 i Susan M. Brookhart në Kapitullin 10 C.F. Ebbber dhe J.L. Lupart (eds.), (2011) Udhëheqja e vlerësimit të nxënësve, studimet në udhëheqjen arsimore.

21 Sherry Bennett dhe Dale Armstrong; Vënia e fokusit në mësimnxënien: Ndryshimi i praktikave të vlerësimit në klasë (Kapitulli 13) faqe 265

22 Po aty: faqe 269

Informatat kthyese të mësimdhënësve nuk garantojnë mësimnxënie; prandaj informatat kthyese si të tilla dhe si ofrohen ato është ajo që stimulon veprimin e nxënësve.

- Ofroni informata kthyese të menjëhershme për njohjen e fakteve (saktë/pa saktë).
- Ndani pak më shumë kohë për të mundësuar rishikime më të plota mendimit dhe shqyrtimit nga ana e nxënësve.
- Asnjëherë mos i vononi informatat kthyese përtej kohës kur do t'u ndihmonin nxënësve.
- Ofroni informata kthyese po aq shpesh sa është praktike, dhe definitivisht për të gjitha detyrat kryesore.
- Vendimet për numrin e informatave kthyese përfshijnë sa pika duhet bërë dhe sa duhet thënë për secilën pikë.
- Caktoni prioritetet për informatat kthyese: komentoni mbi pikën/at më të rëndësishme.
- Zgjidhni pikat që lidhen me qëllimet kryesore të të nxënësve.
- Merrni parasysh nivelin e zhvillimit të nxënësve.

Përzgjidhni mënyrën më të mirë për mesazhin.

- **Informatat kthyese interaktive** (duke biseduar me nxënësin) janë më të mira kur janë të mundshme.
- Përdorini **informata kthyese në formë të shkruar** për punën me shkrim apo në fletën e parë të detyrës.
- Përdorini **demonstrimin** nëse është problem pika “si duhet bërë diçka”, apo nëse nxënësi ka nevojë për ndonjë shembull.

Bëjini informatat kthyese përshkruese më shumë sesa gjykuese.

Mësimdhënësit duhet të vendosin për audiencën e informatave kthyese, duke vendosur nëse duhet t'u japin informata kthyese një nxënësi individual, një grupi të vogël ose të gjithë klasës. Rekomandimet përfshijnë:

- Jepni informata kthyese individuale për të komunikuar, “Mësimdhënësi e vlerëson mësimnxënien nga unë”.
- Jepni informata kthyese për grupin ose klasën, nëse pjesa më e madhe e klasës nuk e ka realizuar konceptin e njëjtë në një detyrë; kjo bëhet një mundësi për mësimdhënie të përsëritur.

FOKUSI PËR INFORMATAT KTHYESE:

- Kur është e mundur përshkruani punën dhe procesin, si dhe raportin ndërmjet tyre.
- Komentoni mbi vetërregullimin e nxënësve nëse komenti do të ndihmonte në vetëefikasitet.
- Shmangjuni komenteve personale.

Hattie dhe Timperley propozuan një model të informatave kthyese që dallon katër nivele: informatat kthyese rreth detyrës (p.sh., informatat kthyese nëse përgjigjet ish-in të sakta ose të gabuara ose udhëzime për të marrë më shumë informata), informatat kthyese rreth realizimit të detyrës (p.sh., informatat kthyese rreth strategjive të përdorura ose strategjitë që mund të përdoren), informatat kthyese në lidhje me vetë-rregullimin

(p.sh., informatat kthyesë në lidhje me vetëvlerësimin ose vetëbesimin e nxënësve) dhe informatat kthyesë rreth nxënësit si person (p.sh., deklaratimet se një nxënës është “i mirë” ose “i zgjuar”). Shqyrtimi i tyre ka gjetur se niveli në të cilin përqendrohen informatat kthyesë ndikon në efektivitetin e tyre. Informatat kthyesë për cilësitë e punës dhe informatat kthyesë rreth procesit ose strategjive të përdorura për të bërë punë janë më të dobishme. Informatat kthyesë që tërheqin vëmendjen e nxënësve në strategjitë e tyre të vetë-rregullimit ose aftësitë e tyre si nxënës mund të jenë efektive nëse nxënësit e dëgjojnë atë në një mënyrë që i bën ata të kuptojnë se do t’i marrin rezultatet që dëshirojnë nëse bëjnë përpjekje dhe i kushtojnë vëmendje. Komentet personale (“Vajzë e mirë!”) nuk tërheqin vëmendjen e nxënësve në mësimnxënien e tyre²³.

Sigurimi i informatave kthyesë nuk ka të bëjë me lavdërimin, por ka të bëjë me ri-drejtimin e fokusit të veprimeve të nxënësve në mësimnxënie.

Specifikimi i informatave kthyesë:

- Specifikimi duhet të jetë sipas nxënësit dhe detyrës.
- Informatat kthyesë duhet të jenë mjaft specifike sa që nxënësi të dijë se çfarë duhet të bëjë, por jo aq specifike saqë të bëjnë punën për të.

Identifikoni gabimet ose llojet e gabimeve, por duke korrigjuar secilin prej tyre (p.sh. redaktimi i kopjeve ose dhënia e përgjigjeve të sakta) nuk i lë hapësirë nxënësit të bëjë asgjë.

²³ Susan M. Brookhart, “Informatat kthyesë të mësimdhënësve në vlerësimin formues të klasës” faqe 232

Shtojca 2: Korniza për Sigurim të Cilësisë së Vlerësimit të Performancës së Shkollës (MASH, 2016)

Hyrje

Si pjesë e masave për zbatimin e kornizës së kurrikulës së re në vend, duket se është e domosdoshme përfshirja e një mekanizmi të llogaridhënies dhe përgjegjësisë në institucionet arsimore. Pjesa thelbësore e këtij mekanizmi është përcaktimi i kritereve të performancës së shkollës, të cilat do të jenë në funksion të monitorimit dhe llogaridhënies, por që gjithashtu do të shërbejnë për menaxhimin e suksesshëm të institucioneve arsimore.

Për këtë qëllim është hartuar Korniza për Sigurimin e Cilësisë së Vlerësimit të Performancës së Shkollës. Kjo kornizë është e strukturuar në pesë fusha të cilësisë:

- Menaxhimi dhe Qeverisja
- Kultura dhe Mjedisi Shkollor
- Mësimdhënia dhe Mësimnxënia
- Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve, dhe
- Performanca e nxënësve

Në procesin e zhvillimit të kornizës së sigurimit të cilësisë për vlerësimin e performancës së shkollës, janë marrë parasysh edhe dokumentet e tjera të miratuara nga MASH-i, në kuadër të iniciativave aktuale për krijimin e një sistemi të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë:

Formularin për Planin Zhvillimor të Shkollës (PZhSh) sipas 8 fushave të cilësisë së shkollës, në bazë të të cilave shkollat faktikisht e përpilojnë Planin Zhvillimor të Shkollës;

- Dimensionet e standardeve për shkollat miqësore për fëmijët;
- Standardet e infrastrukturës;
- Strategjinë për shkollat promovuese të shëndetit.

Zhvillimi i kornizës për vlerësimin e performancës së shkollës bazohet në nevojën e:

- 1 Mobilizimit të akterëve kyç brenda dhe jashtë shkollës për përmirësimin dhe avancimin e performancës së shkollës, duke ofruar një kornizë të qartë të pritjeve nga shkolla;
- 2 Vendosi së një standardi të ri në sistemin arsimor, siç është vetëvlerësimi i performancës së shkollës dhe planifikimi zhvillimor përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse.

Këto dy aspekte janë vendimtare në menaxhimin e institucioneve arsimore, duke krijuar bashkëpunim midis faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve arsimore për nxënësit. Në të njëjtën kohë, një qasje e tillë rrit përgjegjësinë dhe do të ketë efekt në pedagogjizimin e mjedisit shkollor si një institucion me vlerë shoqërore. Gjatë gjithë këtij procesi, nxënësi do të jetë përfituesi më i madh, që është arsyeja kryesore për ekzistimin e shkollës.

1. Cili është qëllimi i këtij dokumenti?

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i pritjeve themelore për secilën shkollë që vepron në Republikën e Kosovës, duke përcaktuar:

- Rolin thelbësor të shkollës
- Karakteristikat e shkollës efektive,
- Kriteret për vlerësimin e cilësisë së performancës së shkollës, dhe
- Treguesit e cilësisë së performancës së shkollës.

2. Çka pritet nga shkollat?

Detyra thelbësore e secilës shkollë në Republikën e Kosovës është që të sigurojë zotërimin e kompetencave kyçe të përcaktuara nga kurrikula shtetërore nga të gjithë nxënësit, në një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës, miqësor dhe inkurajues për të gjithë komunitetin e shkollës²⁴.

Shkolla efektive përdor kapacitetin që ka në dispozicion për të ndërtuar profilin e saj në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve të saj dhe në funksion të avancimit të komunitetit në të cilin vepron.

Për një performancë efektive dhe cilësore, çdo shkollë duhet të ketë:

- Vizion të qartë, të krijuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, të njohur dhe të pranuar nga i gjithë komuniteti i shkollës, i cili pasqyron nevojat specifike të nxënësve të saj dhe zonën ku ajo vepron;
- Mekanizëm efektiv të vetëvlerësimit në lidhje me treguesit e performancës së shkollës të përcaktuar nga MASH-i, dhe në lidhje me vizionin e saj;
- Mekanizëm dhe procedura të qarta të planifikimit zhvillimor me pjesëmarrje të gjerë;
- Agjendë të qartë dhe përkushtim për zhvillimin e vazhdueshëm të praktikave të saj, për të mbështetur nxënësit në mënyrën më të mirë drejt zotërimit të kompetencave kyçe dhe realizimit të potencialit të tyre.

3. Qasja dhe struktura e kornizës së sigurimit të cilësisë të performancës së shkollës

Qasja e sistemit për sigurimin e cilësisë të performancës së shkollës në Kosovë do të jetë para së gjithash për zhvillim, duke shërbyer në planifikimin dhe monitorimin e zhvillimit të shkollës, dhe zbatimit të tij nga shkollat dhe autoritetet arsimore. Njëkohësisht, sistemi i sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës do të shërbejë gjithashtu për të ndjekur, monitoruar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve menaxhuese dhe arsimore të shkollës. Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës ndërtohet mbi ndërveprimin midis (i) parimeve kryesore të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (KKKAP), dhe (ii) fushave të cilësisë së performancës së shkollës. Parimet e KKKAP-së përbëjnë

²⁴ Komuniteti i shkollës përbëhet nga: udhëheqja e shkollës, mësimmhënësit, nxënësit, prindërit, ekipet profesionale dhe administrata e shkollës

themelin e sistemit të vlerave për kornizën e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës, ndërsa fushat e cilësisë sigurojnë strukturën dhe vlerësimin vertikal të ndërlidhjes së gjendjes dhe planifikimit të përmirësimeve. Në mënyrë të veçantë, nga ndërveprimi ndërmjet parimeve të KKKAP-së dhe fushave të cilësisë, përcaktohen kriteret për vlerësimin e performancës së shkollës.

Një qasje e tillë komunikon me reformën aktuale të kurrikulës, me sistemin e menaxhimit dhe sigurimit të cilësisë, duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë, ndërlidhjen dhe koherencën e sistemit arsimor në Kosovë.

3.1. Roli dhe rëndësia e parimeve të Kornizës së Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar për sistemin e sigurimit të cilësisë të performancës së shkollës

Me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar (KKKAP), të miratuar në vitin 2011, MASH-i angazhohet për një qasje të bazuar në kompetenca, përkatësisht një qasje të orientuar drejt rezultateve që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit. Për të siguruar koherencën dhe qëndrueshmërinë e procesit të zbatimit të kësaj qasjeje, KKKAP ka përcaktuar pesë parime themelore:

- 1 Gjithëpërfshirja, e cila i referohet të drejtave të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve për përfshirje të barabartë në arsimin cilësor;
- 2 Zhvillimi i kompetencave, që nënkupton një përcaktim të qartë të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që shoqëria i konsideron të nevojshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe që duhet të udhëheqin të gjithë procesin e planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të punës në shkollë;
- 3 Mësimdhënie dhe mësimnxënie të integruar për të mundësuar të nxënit gjithëpërfshirës, që pasqyron ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe botës së krijuar nga njeriu, me njohuritë dhe informatat që kemi mbi to;
- 4 Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkollë të cilat mundësojnë që shkolla të ndërtojë profilin e saj në interesin më të mirë të nxënësve dhe komunitetit në të cilin vepron, në përputhje me kushtet specifike të personelit mësimor dhe infrastrukturës së saj, si dhe në kuadër të kornizës rregullative të përcaktuar nga MASH-i;
- 5 Përgjegjësia dhe llogaridhënia, që nënkupton krijimin e një mekanizmi të qartë të llogaridhënies për të gjithë hierarkinë e sistemit arsimor, dhe krijimin e kulturës së vlerësimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të shkollës për të rritur nivelin e arritjeve të nxënësve.

Këto parime të KKKAP-së përdoren si bazë e kornizës për sigurimin e cilësisë të performancës së shkollës, gjithmonë në ndërveprim me pesë fushat e cilësisë të performancës së shkollës.

Përshkrimi i fushave të cilësisë

Korniza siguron pesë fusha të cilësisë të performancës së shkollës, të cilat shërbejnë si një bosht organizativ i menaxhimit të shkollës, (vetë) vlerësimit, planifikimit dhe ndërhyrjes përmirësuese. Këto pesë fusha të cilësisë janë: (i) menaxhimi dhe qeverisja, (ii) kultura dhe mjedisi shkollor, (iii) mësimdhënia dhe mësimnxënia, (iv) zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe (v) performanca e nxënësve.

Në vijim kemi një përshkrim të shkurtër të fushave të cilësisë:

Menaxhimi dhe Qeverisja:

Gjatë viteve të fundit, konteksti arsimor në Kosovë ka ndryshuar rrënjësisht. Procesi i decentralizimit të përgjegjësive arsimore (2008), Korniza e Kurrikulës (2011), dhe Kurrikulat Bërthamë (2012), kanë rritur autonominë, përgjegjësinë dhe nivelin e llogaridhënies së shkollës për performancën e shkollës nga ana e nxënësve. Kjo ka sjellë një ndryshim në rolin, misionin dhe përgjegjësitë e udhëheqjes dhe menaxhimit të shkollave. Menaxhmenti i shkollës nuk shihet si zbatues i urdhrave nga lart-poshtë, por si strukturë vendimmarrëse e cila duhet të përqendrohet në proceset e udhëheqjes, menaxhimit, mësimdhënies dhe mësimnxënies, dhe në rezultatet mësimore të shkollës. Rrjedhimisht, menaxhimi i shkollave në Kosovë, sjellja dhe aktivitetet e tyre janë në proces të kalimit nga udhëheqja administrative drejt *“udhëheqjes mësimore”*. Koncepti i *“udhëheqjes mësimore”* i bën organizatat e caktuara të kenë për qëllim kryesor mësimdhënien dhe mësimnxënien, dhe si të tilla të jenë përgjegjëse për performancën arsimore të shkollës, zhvillimin e kompetencave të nxënësve, dhe avancimin e arritjeve të nxënësve. Roli dhe përgjegjësitë e reja kombinojnë administratën me udhëheqjen arsimore.

1.1

Procesi i vlerësimit të performancës së shkollës në këtë fushë të cilësisë do të hulumtojë shkallën dhe natyrën e përfaqësimit të interesave të të gjithë nxënësve, dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit të shkollës në drejtimin e shkollës, zhvillimin e kapaciteteve të shkollës për të mbështetur nxënësit në zotërimin e kompetencave kyçe, efektivitetin e mekanizmave të planifikimit të proceseve mësimore, planifikimin e cilësisë, zbatimin dhe monitorimin e planeve zhvillimore të shkollave, udhëheqjen e zhvillimit të shkollës në përputhje me qëllimin e përbashkët të përcaktuar së bashku në shkollë, dhe mënyrën e identifikimit dhe adresimit të problemeve, sfidave dhe vështirësive akademike, individuale dhe grupore në shkollë.

1.2. Kultura dhe mjedisi shkollor:

Mjedisi i përshtatshëm (atraktiv, miqësor dhe i shëndetshëm) fizik dhe shpirtëror është një parakusht themelor për realizimin e mësimin efektiv dhe të qëndrueshëm. Autoritetet arsimore, komuniteti, menaxhmenti i shkollave dhe mësimdhënësit duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat përkatëse nëse

qëllimi kryesor i tyre është realizimi i misionit në Kosovë - *Zhvillimi i kompetencave të të gjithë nxënësve në përputhje me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës.*

Në kuadër të kësaj fushe të cilësisë do të vlerësohen: infrastruktura fizike, siguria në shkollë dhe rreth saj, shkalla e bashkëpunimit të shkollës me familjet dhe anasjelltas, të gjitha raportet në trekëndëshin menaxhimi - mësimitdhënësi - nxënësit, mjedisi dhe atmosfera në klasë dhe në shkollë, marrëdhëniet ndërnyerëzore, masat për të identifikuar dhe trajtuar faktorët që mund të pengojnë qasjen, pjesëmarrjen dhe arritjet e nxënësve në shkollë, prania eventuale e dhunës fizike në shkollë, por edhe prania e formave më të sofistikuar të dhunës psikologjike dhe emocionale, kërcënimet e mundshme ndaj shëndetit fizik dhe emocional të fëmijëve, si dhe shkalla e pjesëmarrjes së të gjithë akterëve në përmirësimin e mjedisit dhe kulturës shkollore.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj fushe është ofrimi i mundësive për liri kreative dhe mobilizimi i relaksuar i nxënësve dhe mësimitdhënësve. Shkollat gjithashtu mund të zgjedhin krijimin, vlerësimin dhe përmirësimin e indeksit të sigurisë në shkollë, si një instrument që do të ndihmonte në matjen e performancës së kësaj fushe të cilësisë.

1.3 Mësimdhënia dhe Mësimnxënia:

